

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

TEZA:

“DHUNA NË FAMILJE DHE KRIMET MARTESORE NË KOSOVË
NË PERIUDHËN 2013 – 2019”

Kandidat:

Laura R. Tahiri

Mentor:

Doc. Dr. Veditje Ratkoceri

Qershor, 2020

Deklarata e autorësisë

Nën përgjegjësinë time personale deklaroj se përmbajtja e temës së magjistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar nga unë, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tërë ose pjesë të veçanta të tij.

Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Me respekt,

Laura Tahiri

Falënderim

Falenderime të veçanta dhe mirënjohje i dedikoj mentores sime Doc.Dr.Vedije Ratkoceri për mbështetjen e pakursyer të dhënë gjatë realizimit të këtij punimi. Sugjerimet akademike dhe profesionale të mentores sime ishin shumë të dobishme për realizimin e këtij punimi. Gjithashtu, një falenderim të veçantë ja adresoj profesorëve-anëtarëve të komisionit për tërë kontributin e dhënë gjatë periudhës së studimit.

Mirënjohjen i dedikoj familjes time, në veçanti prindërve të mi të cilët më mbështetën, përkrahën dhe më motivuan vazhdimisht për arritjen e synimeve të mija në jetën akademike. Poashtu, mirënjohjen i dedikoj edhe bashkëshkortit dhe familjes së tij të cilët në forma të ndryshme më ndihmuan dhe përkrahën gjatë tërë periudhës kohore të studimeve të magjistraturës.

Laura Tahiri

PËRMBAJTJA

Abstrakt	6
Abstract.....	7
Анстракт	8
Hyrje.....	9
Qëllimi i hulumtimit	11
Hipotezat	12
Metodologjia e hulumtimit.....	14
KAPITULLI I.....	15
NJOHURITË E PËRGJITHSHME MBI DHUNËN NË FAMILJE DHE KRIMET MARTESORE	15
1. Vështrime të përgjithshme	15
2. Marëdhëniet familjare sipas Kanuneve shqiptare	16
3. Kuptimi i përgjithshëm mbi dhunën në familje dhe krimet martesore.....	20
4. Disa elemente qenësore të dhunës në familje dhe krimeve martesore si dhe shkaqe e paraqitjes së tyre	22
5. Përhapja e dhunës ne familje e paraqitur në statistika	25
6. Dhuna në familje dhe krimet martesore në disa vende të regjonit.....	33
7. FORMAT E PARAQITJES SE DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMEVE MARTESORE	42
KAPITULLI II.....	45
FAKTORËT QË NDIKOJNË NË SHFAQJEN E DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMET MARTESORE	45
1. Niveli i ulët i vetëdijes dhe emancipimit.....	45
2. Gjendja e vështirë ekonomike.....	47

3.	Masmediat	48
4.	Mosefikasiteti i zbatimit të ligjeve	50
5.	Papunësia	57
6.	Stresi dhe pasojat e saja në familje.....	58
KAPITULLI III.....		59
EFEKTET DHE PASOJAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMEVE MARTESORE		59
1.	Prishja e raporteve familjare	60
2.	Zgjidhja e martesës dhe pasojat e saja	61
3.	Traumat psikike tek fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes	62
4.	Dobësimi i familjes si celula më e rëndësishme e shoqërisë	63
5.	Viktimat nga dhuna në familje dhe krimet martesore	63
KAPITULLI IV		68
MASAT PREVENTIVE DHE REPRESIVE PËR LUFTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMEVE MARTESORE.....		68
1.	Masat preventive	68
2.	Masat penale, administrative dhe civile	72
PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME.....		77
LITERATURA E SHFRYTEZUAR DHE KONSULTUAR:.....		80

Abstrakt

Dhuna familjare dhe krimet martesore në përgjithësi paraqesin një dukuri të përhapur në shoqërinë kosovare dhe më gjerë. Sot ky lloj krimi paraqet një fenomen shqetësues për tërë shoqërinë, duke atakuar në veçanti anëtarët e ngushtë të familjes, por edhe më gjerë. Dukuria e dhunës në familje dhe krimeve martesore është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore dhe normat etike. Ky lloj krimi paraqet një nga format më të rënda të abuzimit të anëtarëve të familjes ku pasojat negative afatgjate reflektohen ndaj fëmijëve, gruas, bashkëshortit, dhe të cilët shkaktojnë një dëm të madh psikologjik dhe fizik që kanë refleksione negative për pozicionimin e tyre si anëtarë të dobishëm të shoqërisë.

Një ndër format për parandalimin e dhunës në familje dhe krimeve martesore është edhe ndërmarja e disa masave preventive dhe represive me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie kriminale, mjaftë të përhapur në shoqërinë kosovare dhe më gjerë.

Në këtë studim në mënyrë të përgjithësuar është trajtuar çështja e abuzimit të femrës, fëmijëve dhe të moshuarve nga këndvështrime të ndryshme, duke e bërë edhe nga këndvështrimi i të drejtës zakonore shqiptare.

Ky lloj abuzimi gjegjësisht krimi paraqet një fakt shqetësues për shoqërinë tonë, për vet faktin se “numri i errët” për këtë çështje është në shkallë të lartë. Faktorët që kanë ndikuar në këtë janë të shumtë, ku me theks të veçantë dallohet ndikimi i shkallës së mentaliteti individual dhe kolektiv të popullatës; ndikimi i të drejtës zakonore; turpërimi familjar i cili akoma luan një rol vendimtar në Kosovë dhe në disa troje të tjera shqiptare.

Përkundër se ekziston një numër i punimeve të këtij lloji, mendoj se hulumtimet e tilla nuk janë të mjaftueshme për vërjen në pah të kësaj dukurie, prandaj angazhimi im lidhur me këtë temë është një kontribut modest akademik, por i nevojshëm për vënien në pah të kësaj dukurie, parandalimin dhe luftimin e saj.

Fjalët kyçe: Familja, dhuna, krimi, martesë, sanksioni, etj.

Abstract

Domestic violence and marital crimes in general are a widespread phenomenon in Kosovo society and beyond. Today, this type of crime is a worrying phenomenon for the whole society, especially attacking close family members and beyond. The phenomenon of domestic violence and marital crimes is in complete contradiction with legal provisions and ethical norms. This type of crime is one of the most serious forms of abuse of family members where long-term negative consequences are reflected on children, wife, husband, and who cause great psychological and physical damage that have negative reflections on their position as members of useful to society.

One of the forms for the prevention of domestic violence and marital crimes is the undertaking of some preventive and repressive measures in order to prevent and combat this criminal phenomenon, quite widespread in Kosovo society and beyond.

In this study, the issue of abuse of women, children and the elderly from different points of view has been treated in a general way, making it also from the point of view of the Albanian customary law.

This type of abuse, ie crime, is a disturbing fact for our society, due to the fact that the "dark number" for this issue is high. The factors that have influenced this are numerous, where with special emphasis the influence of the degree of individual and collective mentality of the population is distinguished; the influence of customary law; family shame which still plays a crucial role in Kosovo and some other Albanian lands.

Despite the fact that there are a number of works of this kind, I think that such research is not enough to highlight this phenomenon, so my commitment to this topic is a modest academic contribution, but it is necessary to highlight this phenomenon. , preventing and combating it.

Keywords: Family, violence, crime, marriage, sanction.

Апстракт

Семејното насилство и брачните злосторства воопшто се широко распространета појава во косовското општество и пошироко. Денес, овој вид криминал е загрижувачки феномен за целото општество, особено напаѓање на блиски членови на семејството и пошироко. Феноменот на семејно насилство и брачни злосторства е во спротивност со законските одредби и етичките норми. Овој вид на кривично дело е една од најсериозните форми на злоупотреба на членовите на семејството, каде долгорочните негативни последици се рефлектираат врз деца, сопруга, сопруг и кои предизвикуваат голема психолошка и физичка штета што има негативни рефлексии врз нивната позиција како членови на корисно за општеството.

Една од формите за спречување на семејно насилство и брачни злосторства е преземање на некои превентивни и репресивни мерки со цел спречување и борба против овој криминален феномен, доста распространет во косовското општество и пошироко.

Во оваа студија, прашањето за злоупотреба на жени, деца и стари лица од различни аспекти се третира на генерализиран начин, што го прави и од гледна точка на албанскиот вообичаен закон.

Овој вид на злоупотреба, односно криминал, е вознемирувачки факт за нашето општество, се должи на фактот дека „темниот број“ за овој проблем е голем. Факторите што влијаат на тоа се бројни, каде што со посебен акцент се разликува влијанието на степенот на индивидуален и колективен менталитет на населението; влијанието на вообичаеното право; семеен срам кој сè уште игра клучна улога во Косово и некои други албански земји.

И покрај фактот дека има голем број дела од ваков вид, мислам дека ваквото истражување не е доволно за да се истакне овој феномен, така што мојата заложба за

оваа тема е скромен академски придонес, но потребно е да се истакне овој феномен, , спречување и борба против тоа.

Клучни зборови: Семејство, насилство, криминал, брак, санкција.

Hyrje

Dhuna në familje dhe krimet martesore vlerësohen si shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe për adresimin e të cilës bëhen angazhime të pandërprera si në nivel nacional, ashtu edhe ndërkombëtar. Kjo dukuri është e përhapur në mbarë botën, diku më shumë, diku më pak, në forma dhe përmasa të ndryshme, ku një rol të theksuar e luan e drejta zakonore dhe traditat patriarkale që dominojnë në shoqëri. Për këtë arsye institucionet shtetërore por edhe vetë shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare angazhohen në kontinuitet në marrjen e masave të nevojshme për njohjen, trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të tilla të dhunës në familje, duke ofruar siguri të menjëhershme, mbrojtje, shërbime të standardizuara e cilësore për shpëtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të gjithë personave që pësojnë dhunë në familje, pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive apo çdo tipari tjetër individual. Dhuna ndaj grave është identifikuar ndërkombëtarisht si një nga format më të përhapura të dhunës. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), vlerësoi në vitin 2014 se 35% e grave në mbarë botën kanë përjetuar dhunë seksuale apo dhunë në familje në jetën e tyre. Statistikat tregojnë se në nivel global, deri në 38% të vrasjeve të grave janë kryer nga partnerët intimë apo familjarë.

Duke qenë se në bazë të statistikave, gratë dhe vajzat renditen ndër grupet më të cënuara të individëve që pësojnë dhunë në familje, rekomandohet marrja e masave të veçanta dhe fuqizimi i legjislacionit për të ofruar mbrojtjen dhe trajtimin e duhur për këtë grup të synuar. Gjithashtu, shtetet inkurajohen të ndërmarrin një sërë iniciativash edukuese e vetëdijësuese me qëllim që të ndryshojnë mentalitetin patriarkal dhe sjelljet stereotipike që ushqejnë

veprimet e dhunshme si dhe të krijojnë një të kuptuar të përbashkët të trajtimit të këtij fenomeni “përtej dyerve të mbyllura” dhe “me tolerancë zero”.

Në Kosovë, dhuna në familje është një problem i veçantë që ndikon negativisht tek individët, familjet dhe komunitetet në përgjithësi. Në Kosovë qytetarët janë të prirur ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private, familjare dhe si pjesë normale të jetës martesore dhe familjare, përkundër asaj se kemi avansim pozitivë në këtë aspekt. Duke qenë nën ndikimin e të drejtës zakonore, shkallës së mentalitetit “sui generis” për këtë çështje, dhuna në familje shpesh ndodh prapa dyerve të mbyllura dhe mbetet “temë tabu”, nuk rrëfëhet ose nuk trajtohet hapur në shoqërinë kosovare, viktimat vuajnë në mënyrë tipike në heshtje.

Dhuna në familje doli si çështje mjaftë shqetësuese në Kosovë, tek pas luftës së 1999, kur vendi po pësonte një ndryshim domethënës politik, shoqëror, kulturor, emocional, etj. Pas vitit 1999 së bashku me periudhën tranzitore në Kosovë erdhi edhe një numër i madh i organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare, për të përkrahur dhe ndihmuar ndryshimet, reformat e nevojshme institucionale dhe shoqërore. Në këtë periudhë kohore u themeluan edhe OJQ – të vendore të cilat jo pak u fokusuan në çështjet e femrave - grave, duke përfshirë edhe çështjen e problematikës së dhunës ndaj tyre dhe të drejtat e tyre. Pra, në këtë periudhë të pas luftës shoqëria kosovare u ballafaqua me një presion të madh lidhur me fazën e tranzicionit të shoqërisë kosovare, pasi dominonte një shkallë e lartë e dëmtimit dhe humbjes së pasurisë të luajtshme dhe të paluajtshme, një papunësie enorme, mungesës së strehimit si pasojë e shkatërrimeve të mëdha nga lufta, rritja enorme e stresit individual dhe kolektiv, rritja e shqetësimeve sociale, rritja e krimit dhe kriminalitetit në përgjithësi, etj.

Dukuria e dhunës në familje nuk është ndonjë fenomen i ri në shoqërinë kosovare, pasi rrënjët e saja i hasim thellë në shoqërinë e tillë, ku zakonet dhe traditat patriarkale ishin dominante në familjen dhe shoqërinë kosovare – shqiptare. Këto raporte ishin reflektime të Kanunit të Lekë Dukagjinit, të cilat zbatoheshin në disa zona të Kosovës dhe troje tjera shqiptare atëherë, por që fatkeqësisht kanë refleksione zbatuese aty këtu edhe në ditët e sotme.

Ky punim është strukturuar në katër kapituj, duke filluar nga kapitulli i parë lidhur me njohuritë e përgjithshme mbi dhunën në familje dhe krimet martesore, ku në veçanti kam potencuar disa vështrime të përgjithshme mbi historikun e shfaqjes së kësaj dukurie në Kosovë, marëdhëniet

familjare sipas kanuneve shqiptare, kuptimin e përgjithshëm dhe disa elemente qenësore që e karakterizojnë dhunën në familje dhe krimet martesore, format e paraqitjes së saj, duke paraqitur dhe shënime statistikore mbi këtë dukuri në Kosovë dhe në disa vende të regjionit.

Qëllimi i hulumtimit

Bazamentin e një shteti e përbëjnë disa faktorë të rëndësishëm, pa të cilët nuk ka stabilitet të përgjithshëm në një shoqëri. Të tilla janë: Të drejtat dhe liritë e njeriut në përgjithësi, e në veçanti ato brenda familjes dhe institucionit të martesës.

Dhuna familjare dhe krimet martesore paraqesin pengesë serioze dhe ndikojnë negativisht në avancimin e zhvillimit të sistemit juridik, shoqëror, ekonomik, etj., të një vendi.

Prandaj, sundimi i ligjit në një shoqëri është faktor shumë i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin me sukses të dhunës në familje dhe krimeve martesore.

Dhuna në familje dhe krimet martesore janë të sanksionuara edhe me legjislacionin penal të Republikës së Kosovës, por edhe të shteteve tjera ku të drejtat dhe liritë e njeriut janë prioritet i veçantë.

Disa nga qëllimet dhe arsyet që kanë ndikuar për tu marrur trajtimin e kësaj teme janë:

- Kjo temë nuk është trajtuar mjaftueshëm në Republikën e Kosovës dhe më gjerë. Prandaj, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të dhunës në familje dhe krimeve martesore është i nevojshëm studimi i kësaj dukuri kriminale nga këndvështrimet e gjithanshme;
- Në Republikën e Kosovës në bazë të informacioneve paraprake rezulton se viteve të fundit kemi një rritje të numrit të veprave penale të dhunës në familje dhe krimeve martesore;
- “Numri i errët” dhe “numri i përhimtë” lidhur me dhunën në familje dhe krimet martesore është në një shkallë tejet të lartë.

- Përkundër masave të ndërmarra të karakterit preventiv dhe represiv me qëllim të parandalimit dhe luftimit të dhunës në familje dhe krimeve martesore, shoqëria kosovare është ende larg qëllimit për të cilën është lidhur me parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie kriminale.

Nga të gjitha arsyet e lartcekura rezulton se qëllimi i punimit tim është hulumtimi gjegjësisht, njohja, trajtimi dhe analizimi në baza shkencore e dukurisë së dhunës në familje dhe krimeve martesore, shtrirja dhe natyra e saj, faktorët që ndikojnë në shfaqjen e tyre në Republikën e Kosovës dhe në disa vende të regjionit si dhe propozimi i masave preventive dhe represive me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie kriminale.

Hipotezat

Dhuna familjare dhe krimet martesore paraqesin një sfidë permanente që duhet parandaluar dhe luftuar në mënyrë dhe me mjete efikase, në çdo shoqëri ku dukuria e tillë është e pranishme. Një ndër format për parandalimin dhe luftimin e këtij krimi vlerësohet edhe edukimi permanent i anëtarëve të familjes në përgjithësi përmes programeve të veçanta dhe njëherit përmes ashpërsimit të sanksioneve penale ndaj kryerësve të këtyre akteve kriminale. Si disa nga hipotezat kryesore lidhur me këtë çështje janë si vijon: Më qëllim të studimit dhe hulumtimit të dukurisë së dhunës në familje dhe krimeve martesore në Kosovë dhe në disa vende të regjionit, kam ngritur këto hipoteza:

- Në Republikën e Kosovës përkundër asaj se ekziston një infrastrukturë e mjaftueshme ligjore me të cilën definohen dhe sanksionohen çështjet që ndërlidhen me dhunën në familje dhe krimet martesore, zbatimi i këtyre dispozitave është i mangët, jo i plotë dhe jo efikas.
- Dukuria e mangësisë së kontrollit institucional, shkalla e vetëdijes dhe ndikimi i të drejtës zakonore vlerësohen se janë ndër shkaqet që kanë ndikuar në shfaqjen e dhunës

në familje dhe krimeve martesore në Kosovë dhe këto si të tilla janë të përmasave aq të mëdha sa që kanë refleksione shumë negative në shoqërinë në përgjithësi.

- Mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit të drejtësisë, duke filluar nga policia, prokuroria dhe gjyqësia dhe problemet përcjellëse në këto institucione, si mungesa e stafit prokurorial dhe gjyqësorë, lëndët e shumta të pazgjidhura, parashkrimi i lëndëve, tej zgjatja enorme e procedurave gjyqësore, etj., janë disa nga shkaqet që dukuria e dhunës në familje dhe krimet martesore janë prezente në shoqërinë kosovare dhe më gjerë.

Duke u nisur nga hipotezat e lartcekura dhe me qëllim të arritjes së rezultateve të dëshirueshme të hulumtimit, gjatë trajtimit të kësaj teme jam munduar që të jap përgjigje në këto pyetje kërkimore:

- Cfarë ndikimi ka pasur dhe ka e drejta zakonore shqiptare në paraqitjen dhe praninë e dhunës në familje dhe krimeve martesore ?
- Cilët janë faktorët relevantë që ndikojnë në paraqitjen e dhunës në familje dhe krimeve martesore ?
- Cilat janë format e dhunës në familje dhe krimeve martesore në Kosovë dhe në disa shtete të regjionit ?
- Cilat janë motivet kryesore të kryesve të dukurisë së dhunës në familje dhe krimeve martesore ?
- Cilat janë pasojat që rrjedhin nga dhuna në familje dhe krimet martesore në shoqërinë kosovare, por edhe më gjerë ?
- Cfarë ndikimi ka dhuna në familje dhe krimet martesore në rrethin familjar, shoqëror – opinionin publik ?
- Sa ka zbatueshmëri në praktikë legjislativi i cili parandalon dhe lufton dukurinë e dhunës në familje dhe krimeve martesore ?

- Cilat janë masat ekzistuese dhe ato që duhet të ndërmeren për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe krimeve martesore , etj.

Metodologjia e hulumtimit

Gjatë punimit, hulumtimit, kërkimit dhe studimit kam përdorur metodat bashkëkohore karakteristike për shkencat shoqërore. Metodologjia e hulumtimit të këtij punimi ka përfshirë metoda relevante kërkimore hulumtuese. Gjatë hulumtimit kam shfrytëzuar literaturë adekuate studimore si: libra, revista shkencore, shënime zyrtare nga evidencat e disa institucioneve kompetente shtetërore dhe raportet e organizatave joqeveritare të profilizuara në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje, burimet nga webfaqet e ndryshme të internetit, përkundër asaj se rrethanat e pandemisë COVID 19 ishin pengesë serioze për qasje më të afërt për mbledhjen e shënimeve statistikore në insitucionet relevante shtetërore, etj.

Metodat të cilat i kam aplikuar me rastin e hulumtimit të kësaj teme studimi janë:

- Metoda historike;
- Metoda e analizës juridike;
- Metoda komparative;
- Metoda statistikore,
- Metoda e studimit të rasteve individuale, etj.

Përmes metodave të lartcekura jam munduar që ta njoh, trajtoj dhe analizoj në baza shkencore dukurinë e dhunës në familje dhe krimet martesore si dhe të propozoj masat e nevojshme preventive dhe represive me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie të pranishme në shoqërinë kosovare dhe më gjerë.

KAPITULLI I

NJOHURITË E PËRGJITHSHME MBI DHUNËN NË FAMILJE DHE KRIMET MARTESORE

1. Vështrime të përgjithshme

Dukuria e dhunës në familje dhe krimeve martesore është një fenomen shumë i hershëm i shfaqur në historinë e raporteve shoqërore – familjare. Ajo si e tillë ka ndryshuar vetëm për nga format dhe shkaqet e paraqitjes së saj. Poashtu, edhe e drejta zakonore shqiptare në tërësi ka përmbledhur në korpusin e saj mjaft norma me të cilat janë rregulluar dhe sanksionuar të drejtat dhe obligimet e subjekteve në bashkëshortësi dhe familje.

Kanuni një periudhë të gjatë kohore ka shërbyer si autoritet i vetëm ligjor në zona të caktuara gjeografike si rregullator i këtyre raporteve martesore dhe familjare

Pikërisht, në kushtet e mungesës së shtetit, e drejta zakonore, pra kanunet në tërësi, kanë luajtur rolin e rregullatorëve bazikë në marrëdhëniet juridike të popullsisë, njërive të vetëqeverisjes vendore. Nevoja e vlerësimeve, hulumtimeve dhe studimeve intensive dhe ekstensive mbi këto institucione të së drejtës mbetet një kërkesë dhe nevojë si për nevoja të së drejtës juridike aq edhe për interesa historike të popullit tonë.¹

¹ Shiko: Merlika,R. (2018), Kanuni i Bendës - Pjesë e së drejtës zakonore shqiptare, temë (e pabotuar) e doktoratës në Universitetin European të Tiranës, fq.1.

2. Marëdhëniet familjare sipas Kanuneve shqiptare

E drejta zakonore e cila edhe sot është mjaft e zbatueshme në shoqërinë tonë, paraqet një nga pengesat kryesore të zhvillimit të vetëdijes dhe ndryshimit rrënjësorë në qasjen ndaj dhunës në familje dhe krimeve martesore. Prandaj, historiku i shfaqjes së dhunës në familje dhe krimeve martesore burimin e ka pikërisht në kanunet (të drejtën zakonore) të cilat edhe sot zbatohen nga shqiptarët. Normat të cilat janë përcaktuar në këto kanune janë mjaft diskriminuese kur është fjala për pozitën e gruas, femrës në përgjithësi. Pozita e saj në familje por edhe në familjen e bashkëshortit zë një pozitë të veçantë diskriminuese, duke reflektuar pabarazinë gjinore, të drejtat dhe obligimet e saja, gjë që reflekton shfrytëzimin e saj në forma të ndryshme gjatë jetës martesore - familjare.

Ajo që spikat në të gjitha kanunet shqiptare është pozicioni dhe pushteti i të zotit të shtëpisë, pasi gruaja në kanunet shqiptare kishte më tepër detyrime sesa të drejta. Ajo ndër aspektet më kryesore të jetës në familje kishte sundimin nga i zoti i shtëpisë. Ky kishte monopolin e drejtimit të familjes, krahas zonjës së shtëpisë, e cila nuk kishte karakter bashkëdrejtues, por më tepër një rol ndihmës në ushtrimin e mbajtjes nën kontroll të njerëzve të shtëpisë.²

Kështu, sipas Kanunit të Skënderbeut është paraparë se babai ka të drejtë mbi jetën e fëmijëve të tij. Sido që ta dëmtojë ai fëmijën, nuk bie në gjak, pasi konsiderohet si vetëvrasje. Ai ka të drejtë t'i rrahë fëmijët, t'i lërë pa ngrënë, t'i marrë rrogën, t'i fejojë dhe martojë, t'i marrë fitimet. Poashtu, edhe Kanuni i Labërisë thotë se gruaja duhet të lëvizë gjithnjë jashtë shtëpisë e shoqëruar nga një burrë, ajo ka gjithashtu të drejta të kufizuara në pritjen e mysafirëve. Gratë duhet t'u binden urdhrave të të zotit të shtëpisë, burrave dhe djemve të fisit. Punojnë sipas urdhrit që marrin: në ara, për dru, për bar ose me kafshët e gjalla. Duket se gruaja është një

² Merlika, R., vepër e cituar, fq.110

“orendi shtëpiake”, që ndër të tjera duhet të kujdeset për ruajtjen e nderit të vet. Kur kjo nuk ndodh, ajo si rregull vritet. Nderi i vajzës së pamartuar ruhet me rreptësi. Në kapitullin për veprat kundër moralit, përdhunimi i një vajze të pamartuar dënohet me vrasjen e përdhunuesit, ai mund të detyrohet të martohet me vajzën, ose kur kjo nuk e tregon se cili është përdhunuesi, vetë vajza duhet të vritet.³ Pra, pavarësisht se një vajzë është dhunuar, ajo nuk ka të drejtë as të refuzojë martesën me përdhunuesin e saj, madje nëse vajza nga traumat dhe gjendja e saj shpirtërore mund edhe mos të jetë në gjendje të identifikoj përdhunuesin, duhet t’i marrë jetën vetës sepse ndryshe nuk është e pranueshme as në familje dhe as në shoqëri.

2.1 Martesa sipas Kanuneve shqiptare

Martesa ishte një institucion strategjik për familjet shqiptare të kohës kur kanë vepruar kanunet. Këto doke të pashkruara i jepnin çiftit përgjegjësi dhe detyrime, por ndërsa detyrimet e burrit ishin të një karakteri përkujdesës, ato të gruas ishin të një karakteri të bindur dhe të nënshtruar. Kanuni i Lekë Dukagjinit ngarkon burrin dhe gruan me detyra të ndërsjella. Burrit i duhet të kujdeset që familjes të mos i mungojë gjë, si dhe për ruajtjen e nderit të gruas. Nga Kanuni del se gruaja ka detyrë t’i ruajë nderin burrit, t’i shërbejë pa kundërshtim, t’i qëndrojë nën sundim, t’i përgjigjet detyrave të kurorës, të rrisë fëmijët me nder, t’i qëndrojë në gatishmëri për veshjen dhe të mos përzihet në fejesën e bijve dhe bijave. E drejta e vetme e gruas së martuar është të kërkojë që burri ta mbajë, ta veshë dhe ta mbathë. Kanuni thotë se burri e blen mundin e jetës së gruas, por jo vetë jetën e saj. Ai mundet ta rrahë gruan pa pasur probleme me Kanunin dhe familja e saj nuk mund të kërkojë shpërblimin e rrahjes. Kanuni në këtë rast ecën me parimin “Grueja s’bjen në gjak”, “Grueja l’shon më gjak prinden”. Gjithashtu gruas i jepet detyra të durojë sa më shumë burrin e saj, pasi prindërit mund të hyjnë në lojë vetëm në pikën kritike të marrëdhënies. “Burri ka tagër me e kshillue e me qortue gruen, me e

³Merlika, M., vepër e cituar, fq.112

rrahë e me e lidhë gruen e vet, kur të mbërrijë me ia përbuzë fjalën e urdhrit.”⁴ Pra, siç shihet rrënjët e dhunës familjare dhe krimeve martesore në Kosovë kanë dalur nga e drejta zakonore e kodifikuar në disa kanune të cilat edhe sot zbatohen në Kosovë kur vije rasti i çështjeve familjare siç konsiderohet rrahja e gruas ose fëmijëve madje edhe vrasja e tyre.

Përveç këtij rregullimi ekziston edhe parashikimi i detyrave të gruas, trajtimi i saj si send i konkretizuar në parashikimin që “ajo pjell për me e shtu shpin e të punoj për me i ardh krahu burrit”. Sipas Kanunit, ajo është “arë sa për me ushqy fmit, asaj jepi dajakun, mos ja ndaj”. Veçori e kanunit është se sipas tij lejohet martesa disa herë e burrit, nëse nuk ka djalë ose kur gruaja e parë është plakur, duke i vendosur gratë e tij në pozitë të barabartë. Pra, është parashikuar detyrimi i tij për t’i trajtuar njëloj, ndryshe ai përgjigjet sipas kanunit. Të konsideruarit e gruas si mall i shtëpisë shprehet në parashikimin sipas të cilit në rastin e vdekjes së vëllait gruan e tij e merr vëllai, pasi ajo është blerë me pare e, si e tillë, nuk mund të largohet. Në këtë Kanun shihet edhe ndikimi i fesë islame në ndryshim me kanunet e tjera.⁵ Gruaja shihet si një mall dhe jo si njeri, prandaj edhe çdo trajtim çnjerëzor ndaj saj konsiderohet e drejtë për burrin.

Familja në kuptimin e mirëfilltë përfaqësohet nga i zoti i shtëpisë; kreu i bërthamës familjare është bashkëshorti, por fuqitë dhe të drejtat e tij shprehen vetëm kundrejt gruas dhe bijve. Në kuptimin e përgjithshëm të familjes në të dallohen kreu i familjes, që është i zoti i shtëpisë, dhe anëtarët. I zoti i shtëpisë normalisht është më i moshuari i familjes. I zoti i shtëpisë ka të drejtat e njëmendta të sundimit që i ushtron drejtpërdrejt, deri dhe duke dhënë ndëshkime trupore të rënda. Prej tij buron çdo e drejtë dhe zë fill çdo veprim i anëtarëve të familjes, kështu që ai duhet të jetë si shembull në çdo fushë të jetës. I zoti i shtëpisë përfaqëson familjen në të gjitha punët e jashtme kundrejt fisit dhe kundrejt bajrakut. I zoti i shtëpisë mund të japë ndëshkimet e mëposhtme:

- 1) të ndëshkojë gjinden e shtëpisë duke i bërtitur;
- 2) t’i lërë 24 orë pa ngrënë kur gabimi asht i rëndë;
- 3) t’i rrahë kur gabimi është edhe më i rëndë;

⁴ Kanuni i Lekë Dukagjinit, shtëpia botuese “Kuvendi”, Shkodër, 1999, fq.21

⁵ Merlika, M., vepër e cituar, fq.71

- 4) t'i ndajë nga shtëpia, në rast se faji ka prekur nderin e shtëpisë;
- 5) nëse faji i ka vënë faqen e zezë shtëpisë, ka të drejtë dhe t'i vrasë.⁶

Pra sipas të drejtës zakonore i zoti i shtëpisë, apo burri mund të ushtrojë dhunën psikologjike ndaj anëtarëve të familjes, mund të ju mohoj të drejtën për të ngrënë, mund të ushtrojë dhunë fizike duke marr të drejtën në veprimet e tyre që sipas burrit të shtëpisë vlerësohen si faj për të ushtruar dhunë fizike, dhe në fund mund edhe të ju marr jetën nëse vlerëson se ka prekur “nderin” e familjes. Pra, vrasja e gruas në të drejtën zakonore nuk paraqiste vepër e cila duhej të sanksionohej dhe kjo problematikë në literaturë është trajtuar mjaft shumë. Për një shpjegim të drejtë të problemit ka rëndësi themelore të kuptojmë se në normat e kanuneve që rregullojnë marrëdhëniet familjare martesore, gruaja konsiderohet skllave e burrit. Pikërisht për këtë arsye e drejta zakonore sanksiononte të drejtën e burrit për ta varur bashkëshorten kur ajo shkelte besnikërinë bashkëshortore, kur largohej nga shtëpia bashkëshortore ose kur vajza e fejuar refuzonte të shkonte tek i fejuari. Vrasje në rrethana të tilla “de jure” nuk sillnin ndonjë dënim, e për pasojë, as gjakmarrje.

Këto lloj vrasjesh, autorë të ndryshëm i kanë kategorizuar si vrasje për “shkaqe grashë”, vrasje për “çështje nderi” etj., duke e motivuar secilin në njëërën apo tjetrën mënyrë këtë kategorizim. Në të vërtetë këto vrasje mund të ndahen në:

- a) Vrasja e gruas në flagrancë, gjatë kryerjes së aktit seksual: Kjo lloj vrasje si pas të drejtës zakonore nuk quhej krim. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit (më tutje: KLD) thuhet: Ata që kanë shtat e dhunë bashkë, po u vranë në punë të keqe, shkojnë gjakuhupës. Në tekstin e kanunit sillen edhe shembuj në këtë drejtim.

Nga fryma e kanunit del se kjo vrasje nuk sillte përgjegjësi në qoftë se kryhej kundrejt dy personave bashkë në të njëjtën kohë. Në çdo rast ai që kryente vrasjen e gruas detyrohej të bindte familjen e saj se e kishte zënë në faj. Në rast se familja bindej, ai dërgonte fishekun ish-burrit të saj si shenjë që tregonte se e shihnin me vend vrasjen.⁷

⁶ Merlika, R., vepër e cituar, fq.72

⁷ Kanuni i Lekë Dukagjinit, shtëpia botuese “Kuvendi”, Shkodër,1999

b) Vrasja e gruas që largohet nga shtëpia bashkëshortore në kundërshtim me vullnetin e burrit. Kjo vrasje quhet e përligjur sipas kanunit, sepse gruaja, me veprimet e saj, i shkaktonte fyerje të rëndë burrit dhe krejt familjes së tij, pavarësisht se largimi i saj në thelb mund të ishte shfaqje e protestës kundër shtypjes e skllavërisë patriarkale që rëndonte mbi të. Për vrasjen e gruas në këto rrethana autori i krimit nuk i nënshtrohet gjakmarrjes. Pra, pavarësisht sjelljes së burrit ndaj gruas dhe formave të ndryshme të dhunës që ushtroheshin ndaj saj, gruaja nuk kishte të drejtë të shprehte asnjë formë reagimi për veprimet e padrejta ndaj saj dhe rrjedhimisht edhe largimi nga shtëpia pa pëlqimin dhe miratimin e burrit konsiderohej faj për të cilin mund të paguante edhe me jetë. Njëherit në të drejtën zakonore martesë për femrën është lidhur vetëm me pëlqimin e prindërve që ishte kusht i domosdoshëm për krijimin e një raporti martesor mes dy të rinjve. Djemtë varësisht nga mosha kishin të drejtë të zgjedhin vetë nusen, por këtë të drejtë asnjëherë nuk e kishin edhe vajzat. Për vlefshmërinë e martesës nuk ishte i nevojshëm miratimi i ndërsjellë i vajzës dhe djalit: miratimi shprehej nga prindërit dhe ishte gjithmonë urdhër për bijtë.⁸

3. Kuptimi i përgjithshëm mbi dhunën në familje dhe krimet martesore

Organizata Shëndetësore Botërore e ka definuar dhunën si: Përdorim i qëllimshëm i forcës ose fuqisë fizike, nën kërcënim ose real, mbi veten, ose person tjetër ose mbi grup ose bashkësi, që rezulton me, ose ka gjasa të rezultojë me lëndim, vdekje, dëm psikologjik, deformim ose akt të heqjes.⁹

Sipas Konventës së Stambollit, neni 3, “dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve

⁸ Merlika, R., vepër e cituar, fq.72

⁹ Raporti Botëror për Dhunën dhe Shëndetin. Organizata Shëndetësore Botërore, Gjenevë, 2002

aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndanë ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.¹⁰ Pra, “dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.¹¹ Termi “dhuna në familje dhe dhuna në bazë gjinore” përmbledh në vete gjithë spektrin e abuzimeve të cilat në rastet më të shpeshta kryhen tek gratë nga burrat, ose partnerët e tyre. Megjithatë dhuna në familje ndodhë edhe mbi anëtarët e tjerë të familjes, siç janë fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, ose persona të tjerë të marrë nën kujdestari.¹² Sipas Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna familjare¹³ përkufizohet si: “një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në: përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes; çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër; marrëdhëniet seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual; kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër; dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike; hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër.”¹⁴

Ligji e përcakton dhunën në familje si çdo formë abuzimi e ushtruar nga një person ndaj një personi tjetër, e cila rezulton në dhunim të integritetit të tij fizik, moral, psikologjik, seksual, social ose ekonomik. Abuzimi mund të ndodhë në çdo kohë gjatë një marrëdhënieje, përfshirë edhe kohën gjatë së cilës kjo marrëdhënie po mbaron, ose edhe pasi ajo ka përfunduar. Kjo lloj dhune nuk njihet asnjë mjedis kulturor, etnik, arsimor, apo ekonomik. Partnerët abuzivë mund të

¹⁰ Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje Stamboll, 11.V.2011

¹¹ Ligji i Republikës së Kosovës, Nr.9669, datë 18.12.2006 Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare

¹² Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

¹³ Ligji nr. 03/I-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje i Kosovës

¹⁴ Ligji nr. 03/I-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje i Republikës së Kosovës

përdorin një sërë taktikash të ndryshme në përpjekje për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi viktimat e tyre. Abuzimi mund të ndodhë një herë, ose mund të ndodhë me një model të përsëritur dhe të përshkallëzuar gjatë një periudhe prej muajsh apo vitesh. Me kalimin e kohës gjithashtu mund të ndërrojë edhe formë. Ka disa forma të ndryshme dhune në familje, dhe një person mund të jetë subjekt i më shumë se një forme.¹⁵

4. Disa elemente qenësore të dhunës në familje dhe krimeve martesore si dhe shkaqe e paraqitjes së tyre

Në Kosovë ekzistojnë disa elemente që e karakterizojnë dukurinë e dhunës në familje . Duke filluar nga e drejta zakonore e cila është edhe një nga burimet prej nga kjo dukuri në Kosovë merr hov dhe elementi i dytë është mbizotërimi i dhunës në bazë gjinore.

- a) E drejta zakonore vlerësohet me të drejtë si element qenësorë në Kosovë për dhunën në familje dhe krimet martesore, sepse edhe sot në kohën bashkëkohore mendësia e shoqërisë tonë është mendësi me disa elemente kanunesh, mendësi që pavarësisht ndryshimeve shoqërore i ka qëndruar më së shumti kohës dhe kur të arrihet ndryshimi i këtij mentaliteti krimet martesore dhe dhuna familjare do të zvogëlohen dukshëm.
- b) Mbizotërimi i dhunës me bazë gjinore mbetet alarmant në Kosovë. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ka pasur një rritje në numrin e raportuar të rasteve të vrasjeve që kanë rezultuar nga dhuna në familje me bazë gjinore. Në vitin 2015, 68% e grave kanë raportuar se kanë përjetuar një formë të dhunës në familje në jetën e tyre. Në vitin 2017, ka pasur 1,299 raste të raportuara të dhunës në familje në polici. Dhunimi, sulmet seksuale dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore vazhdojnë të mbizotërojnë, por

¹⁵ Manual i OSBE-së në Shqipëri - Si të kërkojmë Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Tiranë, 2013

nuk janë mjaftueshëm të raportuara. Për më tepër, vlerësohet se 64% e grave janë ngacmuar seksualisht gjatë jetës së tyre.¹⁶

Dhuna në familje është fenomen i përhapur në shoqërinë tonë, i cili ndodh mes partnerëve të ngushtë në familje, si dhe ndodh në të gjitha klasat shoqërore, pavarësisht moshës, arsimit, fesë, gjendjes ekonomike, etnisë ose identitetit kulturor. Të dhënat zyrtare sipas anketimit të fundit për dhunën në familje në Shqipëri tregojnë se të paktën 59.4% e grave kanë përjetuar një nga format e dhunës në familje. Dhuna në familje është një sjellje e udhëhequr nga nevoja për të pasur kontroll. Mund të nisë nga kërcënimet, telefonatat bezdisëse dhe ndjekjet e deri tek marrëdhëniet seksuale të padëshiruara, goditjet, dhe në rastin më të keq deri në vdekje. Dhuna në familje zakonisht nuk është një rast i veçuar dhe shpesh bëhet më e ashpër dhe më e shpeshtë me kalimin e kohës. Në mënyrë të përsëritur dhunuesit e mohojnë dhunën në familje dhe ashpërsinë e kësaj dhune. Kur ballafaqohen me sjelljen e tyre abuzive, ata kanë tendencën të fajësojnë partneren e tyre se i ka provokuar, ose refuzojnë të pranojnë përgjegjësinë. Shpesh abuzuesi shpreh keqardhje dhe viktimat dëshiron të besojë që abuzimi nuk do të ndodhë më. Megjithatë ka një sërë faktorësh që çojnë në dhunë në familje, kjo gjithmonë është e lidhur me pabarazitë dhe çekuilibrin e pushtetit në marrëdhënie. Por më pas, ndodh përsëri e përsëri. Dhuna përshkallëzohet nëse nuk ndërmerren masa për të ndryshuar situatën. Dhuna në familje është problem kompleks që përfshin më shumë se sa një akt në vetvete në marrëdhëniet personale mes burrit dhe gruas. Është një problem social me përmasa të gjera që i ka rrënjët në qëndrimet historike ndaj gruas në nivel martesor. Socializimi i grave dhe burrave në shoqërinë tonë dhe caktimi i grave në role dhe pozita inferiore që i mbajnë gratë të varura ekonomisht, i bëjnë ato me të ekspozuara ndaj dhunës së burrave. Ky viktimizim i grave nga bashkëshortët e tyre përforcohet nga gjendja ekonomike, mentaliteti dhe tradita, si dhe ndërgjegjësimi jo i mjaftueshëm i njerëzve mbi dhunën në familje. Ndërsa dhuna ndaj gruas po bëhet gjithmonë dhe më tepër problem shqetësues në shoqëri, pasi shumë burra ndihen të kërcënuar nga koncepti i lirisë së grave. Studimi i dhunës në familje vështirësohet po të kemi parasysh edhe

¹⁶ Shiko: Mustafa- Qosaj, A., & Morina, D., (2018) Raport i Politikave - Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë, Kosovar Institute for Policy Research and Development.

një numër tabush që nuk lejojnë depërtimin në thelbin e problemit. Kështu, në komunitete dhe mjedise të ndryshme sociale ndahen mendime se “dhuna prek vetëm një shtresë apo grupe të caktuara”, “dhuna është një problem i të varfërve”, “gratë e dhunuara kanë personalitete të caktuara që e nxisin ushtrimin e dhunës nga bashkëshorti”, “gratë e dhunuara qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme sepse ato e pranojnë dhunën”, “dhuna është rastësore dhe ndodh shumë rrallë”, etj. Të gjitha këto etiketime çojnë në një theksim të stereotipit të shoqërisë patriarkale dhe bëjnë të mirëqenë konceptin se dhuna është një fenomen i cili vazhdon të pranohet. Dhuna në familje përbën abuzimin më të shpeshtë me të drejtat e njeriut, por njëkohësisht mbetet i izoluar në qarkun e mbyllur të familjes. Ky abuzim është edhe një problem shëndetësor i cili bëhet shkak për plagë shpirtërore, fizike madje dhe vdekje. Ai cenon mirëqenien e grave dhe gërryen dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Është fakt i mirënjohur që dhuna në familje është një fenomen, i cili i kapërcen të gjithë kufijtë dhe gjendet në të gjitha kulturat apo shtresat e shoqërisë. Rastet më të shpeshta të dhunës në familje kanë për viktima femrat që kryesisht janë nëna me fëmijë të mitur (gjithashtu viktima të dhunës në familje). Dhuna në familje dhe abuzimi ndaj grave është një problem kompleks dhe shumëdimensional. Kjo sepse përfshihen faktorë familjarë, individualë, shoqërorë dhe kulturorë. Këta faktorë ndikojnë në probabilitetin që gratë mund të bëhen viktima të dhunës.¹⁷

Shpeshtësia e dhunës me bazë gjinore ndaj grave në Kosovë mund të karakterizohet si pandemike. Vlerësohet se një në çdo tre gra ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri dhe se një në çdo dhjetë gra kanë përjetuar marrëdhënie të dhunshme ose akte të tjera seksuale në një moment të caktuar të jetës së tyre. Dhuna me bazë gjinore kundër grave është e përkufizuar si dhunë që i ndikon gratë në mënyrë jo proporcionale, apo dhunë që drejtohet kundër një gruaje për faktin e vetëm se ajo është një grua. Llojet e dhunës që përfshihen në këtë përkufizim janë: dhuna seksuale dhe dhunimi, krimet e “nderit”, gjymtimi gjenital, dhuna në familje, ngacmimi seksual dhe martesë e detyruar. Në përgjithësi, këto forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore konsiderohen si mjete me të cilat gratë janë në vartësi sociale, politike dhe ekonomike.¹⁸

¹⁷ Hasanbelliu, A. (2017), *Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Dhunës në Familje*, fq.4

¹⁸ Shiko: Mustafa- Qosaj, A., & Morina, D., (2018) *Raport i Politikave - Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë*, Kosovar Institute for Policy Research and Development.

5. Përhapja e dhunës ne familje e paraqitur në statistika

Përsa i takon të gjitha formave të dhunës ndaj grave në Kosovë, praktikat e mbledhjes së të dhënave sociale, gjyqësore, administrative dhe mbi bazën e shërbimeve janë jo të kënaqshme. Kur bëhen përpjekje për të matur shkallën dhe natyrën e problemit, kjo gjë paraqet një sfidë. Sidoqoftë, statistikat zyrtare të mbledhura në mënyrë sporadike dhe anketimet e kryera nga organizatat joqeveritare tregojnë se fenomeni është mjaftë i përhapur. Dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve përfaqëson formën më të përhapur të dhunës, ku kryesit e veprave penale janë më së shumti partnerët meshkuj dhe/ose bashkëshortët aktualë ose të mëparshëm. Të dhënat e policisë tregojnë se, në vitin 2016, gratë përbënin 80% të 1.247 rasteve të dhunës në familje të denoncuar në polici. Autoritetet dhe organizatat e grave vlerësojnë se numri i viktimave është shumë më i madh. Agjencia për Barazi Gjinore në Kosovë vlerësonte se, në vitin 2008, nuk është bërë kallëzim për afro 90% të rasteve. Në mungesën e kallëzimit kontribuojnë të gjitha – pikëpamjet e përhapura se dhuna në familje është çështje private, ndërthurur me stigmën sociale, frikën nga hakmarrja, mungesën e besimit te autoritetet kompetente dhe varësinë ekonomike nga kryesi i veprës penale. Sipas një anketimi të kryer në vitin 2014 nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës ka rezultuar se:

- 41% e grave dhe 20% e burrave janë shprehur se kanë përjetuar një formë të dhunës në familje, përfshirë dhunën fizike, psikologjike dhe/ose ekonomike;
- 68% e grave dhe 56% e burrave, gjithashtu, kanë thënë se në jetën e tyre kanë përjetuar dhunë në familje.
- 21% të kosovarëve iu duket e pranueshme që bashkëshorti nganjëherë ta godasë gruan.
- 32% mendon se: “Kur grindet çifti, është e natyrshme që nganjëherë të ndodhë dhunë fizike.

Tabloja është më pak e qartë përsa i takon formave të tjera të dhunës që parashikon Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit). Viktimat rrallëherë bëjnë kallëzim për dhunën seksuale, përfshirë përdhunimin, që ndodh brenda dhe jashtë familjes apo njësisë shtëpiake. Stigma sociale që lidhet me këtë formë të dhunës do të thotë se viktimat, të cilat dalin publikisht, përballen me izolimin që i bën shoqëria, divorcin, mospranimin nga ana e pjesëtarëve të familjes dhe gjykimin si të papërshtatshme për martesë. Një stigmatizim i tillë, bashkë me mungesën e pranimit dhe korrigjimit nga ana e autoriteteve, gjithashtu, ka penguar shumë gra viktima të dhunës seksuale gjatë konfliktit që të kërkojnë shërbime dhe drejtësi. Ndonëse nuk ekzistojnë statistika zyrtare, të dhënat nga anketimet jozyrtare tregojnë se, në jetën e tyre, një shifër paraprake prej:

- 64% e grave ka përjetuar një formë të ngacmimit seksual.
- Fakti që 74% e kosovarëve mendon se gratë e shkaktojnë vetë ngacmimin seksual me anë të veshjeve apo veprimeve provokuese, apo që 41% mendon se grave të reja u pëlqen që t'i ngacmojnë, kontribuon në masë të madhe në krijimin e mjedisit fajësues ndaj viktimave dhe mundësimin e dhunës të këtij lloji.

Në Kosovë fenomeni i martesave të fëmijëve dhe martesave në një periudhë të hershme është relativisht i rrallë, por vazhdon të jetë i përhapur te komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane. Edhe për këtë, sërish, është vështirë të sigurohen statistika të sakta, sidomos meqenëse pjesa më e madhe e martesave nuk regjistrohet menjëherë pranë autoriteteve nga frika e dënimeve penale dmth. “numri i errët” është në nivel tejet të lartë. Një gjë e sigurt është se martesa në një periudhë të hershme pritet që të prekë në mënyrë shpërpjesëtimore vajzat, sidomos nga familjet e varfëra. Nuk janë dokumentuar mjaftueshëm as format e tjera të dhunës ndaj grave që parashikon Konventa e Stambollit, si: ndjekja, gjymtimi i organeve gjentiale femërore, aborti i detyruar dhe sterilizimi dhe krimet që kryhen në emër të të ashtuquajturit nder.¹⁹

¹⁹ Krol, K., (2017), Krijimi i Hartës së Shërbimeve Mbështetëse për Viktimat e Dhunës ndaj Grave në Kosovë, Projekti i Këshillit të Evropës, “Forcimi i Luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë”.

Tabela 1 Rastet e Dhunës në Familje të Raportuara në Policinë e Kosovës (Të dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës)				
Viti	2015	2016	2017	Janar-Korrik 2018
Te raportuara nga gratë	862	992	990	515
Te raportuara nga burrat	202	255	309	123
Mbi moshën 65 vjeq	N/A	N/A	129	59
Shqiptarë	879	1051	1045	523
Serb	88	90	87	40
Rom	26	20	40	12
Ashkali	26	34	36	16
Egjiptian	11	6	31	7
Goran	14	12	8	3
Turq	7	12	4	11
Boshnjak	10	16	35	18
Të tjerë	3	6	13	8

Sipas tabelës nr.1²⁰ rezulton se në vitin 2016 kemi pasur numrin më të madh të rasteve të raportuara nga gratë kosovare lidhur me dhunën në famije, me gjithësejt 992 raste, ndërsa raste të tilla të raportuara nga burrat kemi pasur në vitin 2017. Sa i përket nacionalitetit të rasteve janë dalluar për nga nacionaliteti shqiptarët me 1051 raste në vitin 2017, ndërsa më së paku raste ka pasur nga nacionaliteti goran me 3 raste gjë që tregon se struktura e popullsisë shumicë në Kosovë ka raste më të shumta të dhunës në familje, gjë që në aspektin demografik dhe kriminologjik ka arsyetimin e saj.

²⁰ Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës për periudhën e hulumtuar.

Tabela 2. Shkeljet Penale lidhur me dhunën në familje			
Vitet	2016	2017	2018
Numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale	2959	1009	1241
Kërkesat për paraburgim	84	115	69
Hedhja poshtë e kallëzimeve penale	838	521	188
Aktakuza të drejtëpërdejtja	1716	1220	419
Hetimet e iniciuara	683	231	157
Aktakuzat e ngritura pas hetimeve	591	378	189
Hedhjet poshtë të procedurave pas skadimit të periudhës së parashkrimit	2	0	2
Propozimi për caktimin e masave mbrojtëse	23	24	13
Aktgjykime refuzuese	94	62	20

Tabela nr.2²¹ na pasqyron shkeljet penale lidhur me dhunën në familje në Kosovë gjatë periudhës kohore 2016 – 2018 nga e cila rezulton se: Numrin më të madh të kallëzimeve penale e kemi pasur në vitin 2016 me 2959 raste, ndërsa numri më i vogël ishte në vitin 2017, me 1009 raste. Pra, kemi një zvogëlim të kallëzimeve penale prej afër 300%, por që pas aktakuzave të ngritura dhe hetimeve të bëra ka rezultuar në 591 raste në vitin 2016 dhe 378 raste në vitin 2017. Pra, kemi një zvogëlim të këtij raporti dallues gjegjësisht një disproporcioni evident mes numrit të rasteve të kallëzimeve penale gjatë kësaj periudhe kohore dhe aktakuzave të ngritura pas hetimeve. Një mangësi e evidente në tërë këtë proces është fakti i numrit të vogël të propozimeve për caktimin e masave mbrojtëse, përkundër asaj se praktika parapenale, penale – gjyqësore tregon se në shumicën e rasteve të dhunës në familje pala e dhunuar e kërkon një masë të tillë shqiptimi.

²¹ Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës për periudhën e hulumtuar.

Tabela 3. Rastet Penale në lidhje me dhunën në familje të dënuara nga gjykatat				
Vitet	2015	2016	2017	2018
Numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale për periudhën raportuese	2667	2959	1009	1241
Urdhrat ndëshkues të lëshuar me aktgjykim.	300	394	44	28
Raste të mbyllura për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit	18	28	15	0
Me aktgjykim lirues	11	12	2	0
Aktgjykim fajësues	901	1055	776	455
Masat për trajtim të detyrueshëm	23	17	11	8

Tabela nr.3²² na pasqyron rastet penale në lidhje me dhunën në familje të dënuara nga gjykatat gjatë periudhës 2015 - 2018, nga e cila rezulton se në vitin 2016 kemi pasur numrin më të madh të kallëzimeve penale të parashtruara në Kosovë për periudhën raportuese, me 2959 kallëzime penale, ndërsa numrin më të vogël në vitin 2017, me 1009 kallëzime penale; Sa i përket aktgjykimeve fajësuese numrin më të madh e kemi pasur në vitin 2016, ndërsa më të ulët në vitin në vitin 2018, me 455 aktgjykime. Këto shënime statistikore na pasqyrojnë një disproportcion të theksuar mes numrit të kallëzimeve penale dhe numrit të aktgjykimeve fajësuese gjatë periudhës sa raportuar.

²² Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës për periudhën e hulumtuar.

Tabela 4.Rastet e raportuara ne Polici te Degradimit Seksual			
Viti	2015	2016	2017
Dhunim seksual	5	7	3
Sulm seksual	17	12	7
Degradim i integritetit seksual	2	0	1
Abuzim seksual i personave me aftësi të kufizuara mentale apo fizike	1	3	0
Abuzim seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare (16)	36	35	26
Abuzim seksual duke përdorur pozitën,autonitetin apo profesionin	1	0	0

Në tabelën nr.4.²³ janë pasqyruar shënimet statistikore të raportuara në Policinë e Kosovës për periudhën 2015 – 2017 lidhur me degradimin seksual pasqyrojnë se dhunime seksuale më së shumti gjatë periudhës raportuese kemi pasur në vitin 2016, gjithësejt 7 raste, ndësa më së paku në vitin 2017, me 3 raste. Ndërsa, është për tu veçuar se gjatë kësaj periudhe kemi pasur abuzime seksuale të personave me aftësi të kufizuara mentale dhe fizike. Kështu, në vitin 2016 kemi pasur 3 raste, ndërsa në vitin 2017 asnjë rast. Kjo tregon se as kjo kategori e veçantë e qenieve njerëzore ka qenë e atakuar nga këto lloje të veprimeve kriminale – krimeve.

²³ Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës për periudhën e hulumtuar.

Tabela 5/Aktakuzat penale kundër Integritetit Seksual				
Viti	2015	2016	2017	2018
Numri i përgjithshëm i aktakuzave penale në fillim të periudhës së raportimit	141	160	109	190
Numri i investigimeve të pazgjidhura në fillim të periudhës së raportimit				
Kërkesa për denim	32	31	26	11
Lirim nga aktakuzat penale	12	28	22	21
Pa di drekte	10	8	18	0
Vendim për inicim të investigimit	118	159	140	52
Aktakuza pas procedurës hetimore	90	137	100	48
Ndërprerja e procedurës për shkak të afatit ligjor të parashkruar	0	0	1	0
Propozimi për të vendosur masa të detyrueshme të trajtimit	1	0	0	0

Tabela nr.5²⁴ na pasqyron aktakuzat penale kundër integritetit seksual nga e cila rezulton se gjatë periudhës së raportimit 2015 – 2018, numri i përgjithshëm i aktakuzave penale ishte 600, ku prej tyre 83 ishin lirime nga aktakuza penale dhe 375 ishin aktakuza pas procedurës hetimore. Është për tu veçuar se gjatë kësaj periudhe të hulumtuar kanë munguar propozimet për të vendosur masa të detyrueshme të trajtimit, gjë që është befasese dhe e pajustificueshme.

²⁴Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës për periudhën e hulumtuar.

Tabela 6. Rastet e Sulmeve Seksuale të dënuara nga Gjykatat						
Aktakuzat mbi Sulmet Seksuale				Rastet e dhunimeve		
Viti	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Numri total	28	33	18	19	30	4
Paraburgim/Dënim me burgim	6	6	2	8	9	2
Dënim me gjobë	4	9	8	0	2	0
Dënim me kusht	5	5	3	3	5	0
Dënime tjera	1	0	0	1	0	0
Me aktgjykim lirues	1	3	1	2	4	2
Me aktgjykim refuzues	3	4	1	1	4	0
Rastet e parashkuara	0	4	2	2	1	0
Të vendosura ndryshe	8	2	1	2	5	0

Tab.nr.6²⁵ na pasqyron periudhën 2016 -2018 lidhur me dënimet gjyqësore për veprën penale sulmet seksuale në Kosovë, ku për dhunime u dënuan për vitet raportuese gjithësejt 53 vetë dhe atë me burg efektiv vetëm: 19 vetë, ndërsa dënime me gjobë 2 vetë, si dhe 8 vetë me dënim me kusht. Me aktgjykim u liruan 8 vetë, me aktgjykim refuzues 5 vetë si dhe u parashkruan 3 raste. Këto statistika na pasqyrojnë një mosefikasitet të theksuar të institucioneve të sistemit të drejtësisë në Kosovë në luftimin dhe parandalimin e krimeve - veprave penale që atakojnë integritetin seksual të viktimave.

²⁵ Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës për periudhën e hulumtuar.

6. Dhuna në familje dhe krimet martesore në disa vende të regjonit.

6.1 SHQIPËRIA

Me rënien e komunizmit në vitin 1991, institucionet shtetërore shqiptare janë angazhuar për unifikimin e sistemit juridik shqiptar me standardet ndërkombëtare, duke miratuar e ratifikuar marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare të lidhura me antidiskriminimin në përgjithësi dhe dhunën në familje, në veçanti.

Republika e Shqipërisë është pjesë e Konventave të mëposhtme të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, e ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (CRC) e ratifikuar më 27 shkurt 1992. Kjo konventë I siguron shtetit një autorizim të qartë për mbrojtjen e fëmijës nga çdo lloj forme dhune në shtëpi dhe familje dhe përcakton rolin e tij si një arbitër kryesor për mirëqenien e fëmijës në ambientin familjar.
- Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese, e ratifikuar më 11 maj 1994.
- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e ratifikuar më 11 maj 1994.
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollit përkatës i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të ratifikuara më 10 shkurt 1996.
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese, e ratifikuar më 10 shkurt 1996. Në shtator 2010, qeveria shqiptare nënshkroi Deklaratën e Mijëvjeçarit, ku përfshihen edhe Objektivat e

Zhvillimit të Mijëvjeçarit, një prej të cilëve është edhe barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas.²⁶

Në Shqipëri dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek gratë dhe fëmijët, si edhe tek familjet dhe bashkësitë. Megjithatë, shpesh priremi ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private dhe si një pjesë normale të jetës bashkëshortore e familjare. Dhuna në familje u shfaq si problem shqetësues në Shqipëri në vitet '90, kur vendi po përjetonte ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore. Ndonëse dhuna në familje kishte ekzistuar shumë kohë përpara kësaj periudhe tranzicioni, rastet e dhunës në familje pësuan rritje të ndjeshme në vitet '90, ndërkohë që familjet po përjetonin shumë stresa dhe trysni si pasojë e tranzicionit. Nisur nga niveli, shpeshtësia si dhe kosto sociale, dhuna me bazë gjinore mbetet një shqetësim i madh në Shqipëri, si një nga dhunimet më serioze dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në vend. Dhuna në familje u shfaq si problem shqetësues në Shqipëri në vitet '90, kur vendi po përjetonte ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore, por dhuna në familje ndaj grave nuk është dukuri e re në Shqipëri; ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale që prej kohësh i kanë dhënë formë shoqërisë shqiptare.²⁷ Nga të dhënat zyrtare shtetërore shqiptare²⁸ janë evidentuar dhe trajtuar 4,157 raste të dhunës në familje, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2015 janë evidentuar 3,866 raste të dhunës në familje. Duke krahasuar treguesit e periudhave të mësipërme, rezulton se *gjatë vitit 2016 janë evidentuar 297 raste të dhunës në familje me shumë, ose rreth 7.7% më shumë*. Gjatë vitit 2015 janë plotësuar 2,148 kërkesë-padi Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes, ndërsa për vitin 2016 janë trajtuar me kërkesë - padi 2,207 raste. Gjatë vitit 2016 vërehet rritje e indikatorit kërkesë padi për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje/Urdhër Mbrojtjeje me 59 raste ose rreth 3% më shumë se sa në vitin 2015.²⁹ Gjatë vitit 2016 të dëmtuara nga dhuna në familje kanë qenë 3,062 gra/vajza ose 78% të numrit total të viktimave të dhunës, ndërsa 1,095 ose 22% janë burra.³⁰

²⁶ Raport i Studimit Bazë mbi Dhunën në Familje dhe Policinë e Shtetit Shqiptar, Instituti Studimor, "Data Centrum", 2012

²⁷ Shiko: Hasanbelliu, A. (2017), *Funksionimi i Mekanizmit kombëtar të referimit të dhunës në familje*, Tiranë

²⁸ Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë të periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2016

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty

Viktimat gra/vajza janë bashkëshorte, motra, kunata, nëna, bija dhe numri i madh i tyre tregon qartë për ndikimin gjinor të dhunës. Ndërkohë, vetëm bashkëshorte të dëmtuara nga dhuna janë 1,531 ose rreth 36.8 % të numrit total të viktimave të dhunës në familje, ose 50% e numrit total të grave/vajzave të dëmtuara nga dhuna në familje. Sa i përket të miturve nën 18 vjeç, të dëmtuar nga dhuna dhe krime të tjera të ndodhura në familje, janë 186 raste. Për vitin 2016 vihet gjithashtu re se në 119 raste janë shkelur Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes//Urdhrat e Mbrojtjes të dhëna nga Gjykatat e Shkallës së Parë, ndërsa gjatë vitit 2015 janë evidentuar/trajtuar 112 raste të shkeljes së Urdhrave të Mbrojtjes. Gjatë vitit 2016 janë referuar materialet në prokurori, në bazë të nenit 130/a të Kodit Penal për 1,488 raste, kundrejt 1,299 rasteve të referuar në 2015. Nga krahasimi i treguesve rezulton se, gjatë vitit 2016 janë referuar në prokurori 189 raste, ose 14.5% me shumë vepra penale, si dhe janë arrestuar 154 autorë më shumë. Rritja e numrit të arrestimeve është një masë parandaluese ndaj dhunës dhe krimit në familje. Gjatë vitit 2016 kanë ndodhur 16 vrasje në familje (përkatësisht sipas nenit 79/c të Kodit Penal), me 17 viktima. Gjatë vitit 2015 u evidentuan 18 vrasje me 20 viktima.³¹ Nga krahasimi i numrit të vrasjeve, gjatë vitit 2016 u evidentua një vrasje më pak se në vitin 2015, si dhe 3 viktima më pak.³²

³² Shiko: Hasanbelliu, A. (2017), *Funksionimi i Mekanizmit kombëtar të referimit të dhunës në familje*.

6.2 MAQEDONIA E VERIUT

Akti më i lartë juridik³³ i Maqedonisë së Veriut e garanton barazinë dhe e ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë dhe dhunës ndaj grave dhe format tjera të diskriminimit. Maqedonia e Veriut është ratifikuese e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) e cila hyri në fuqi në korrik të vitit 2018.

Përkundër asaj se legjislacioni e mbulon barazinë gjinore, dhunën në familje, ngacmimin seksual, dhunën seksuale dhe fizike, përdhunimin martesor dhe denoncimin e detyrueshëm, ajo nuk e bënë edhe grumbullimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Gjithashtu edhe Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut³⁴ e trajton dhunën në familje dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, me ç'rast disa vepra penale konsiderohen si më të rënda nëse janë kryer në lidhje të ngushtë personale. Sipas Ligjit³⁵ për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje nga viti 2014, dhuna ndaj grave rregullohet si formë e dhunës në familje. Përdhunimi është vepër penale e ndëshkueshme prej 1 deri 15 vjet burgim. Por, është kusht i domosdoshëm që të dëshmohet përdhunimi duhet të ketë përdorim të forcës ose kërcënimit me forcë, dhe jo vetëm mospajtim nga viktimat. Ndërsa, përdhunimi në martesë është vepër penale, por që inicohet vetëm përmes padisë private.

Dhuna ndaj grave konsiderohet si një dukuri mjaft e përhapur. Tri nga pesë gra (60%) ishin të mendimit se dhuna ndaj grave është e zakonshme, ndërsa përafërsisht tri nga dhjetë gra ishin të mendimit se kjo është një dukuri mjaft e shpeshtë. Përafërsisht një nga pesë gra (17%) personalisht njohin dikë në familjen e tyre dhe shoqe të tyre të cilat kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje, ndërsa kemi një përqindje të ngjashme të personave nga fqinjët e tyre të cilët kanë përjetuar dhunë. Pak më shumë se gjysma e grave (54%) kohë më parë kanë parë ose dëgjuar për fushata promovuese që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, ndërsa

³³ Kushtetuta e Maqedonisë Nr. 08-4642/1, 17 nëntor 1991, me ndryshmet tjera kushtetuese deri më 2019

³⁴ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 139/2008, me ndryshimet dhe plotësime.

³⁵ Ligji për parandalim, ndalesë dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr..138/2014, 33/2015, 150/2015. Ky ligj u miratua në vitin 2014 dhe ka hyrë në fuqi më datën 1.01.2015. Ky ligj rregullon veprimin e tërësishëm të institucioneve dhe shoqatave të qytetarëve në parandalimin dhe parandalimin e dhunës në familje dhe në sigurimin e mbrojtjes së viktimave.

shumica e tyre mendojnë se deri diku janë të informuara se si duhet të veprojnë nëse gjenden në situatë të tillë (63%). Përkundër asaj se shtrirja e konstatuar e dhunës në familje është në nivel të konsiderueshëm më e ulët sesa në gjithë BE-në, duhet të merret parasysh se trefish më shumë gra në Maqedoninë e Veriut janë të mendimit se dhuna në familje është çështje private që duhet të mbetet brenda familjes, në krahasim me gratë në BE-së, dhe sondazhi cilësor i realizuar për qëllimet e këtij Raporti tregoi se disa gra janë të mendimit se ndonjë dhunë “më e vogël” është sjellje normale. Gratë më të reja, si dhe ato që janë më të arsimuara dhe ato që jetojnë në mjedise urbane, janë më të ekspozuara ndaj ngacmimeve seksuale. Tek gratë të cilat jetojnë në familje me vështirësi financiare ekziston prevalencë më e madhe e dhunës, dhe veçanërisht të dhunës fizike dhe seksuale nga partneri intim (17%). Sa u përket autorëve të dhunës, dhunën fizike dhe/ose seksuale më së shpeshti e ushtron partneri i mëparshëm: 12% e grave të cilat paraprakisht kanë pasur partner janë përgjigjur se kanë përjetuar një ose më shumë forma të kësaj natyre të dhunës, në krahasim me 7% të atyre të cilat thanë se janë viktimat të dhunës nga partneri aktual. Shtatë për qind e grave deklaruan se kanë përjetuar dhunë nga jo-partneri që në moshën 15 vjeçare. Viktimat e dhunës fizike ose seksuale nga partneri ose jo-partneri, shpeshherë ndihen të mërzitura, të frikësuara dhe të zemëruara, dhe secilën ndjenjë e shprehën më shumë se gjysma e grave të prekura, ndërsa përafërsisht një e katërta e grave të anketuara kanë vuajtur nga vështirësitë me gjumin, me depresionin dhe ndjenjën e brishtësisë si rezultat i incidentit më serioz të dhunës që iu ka ndodhur. Ekziston një minoritet i konsiderueshëm i cili e respekton qëndrimin tradicional të rolit të grave në shoqëri dhe në familje. Rreth një e treta e grave (37%) ishin të mendimit se miqtë e tyre do të pajtohen me atë se një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo vetë nuk është dakord, ndërsa një përqindje e ngjashme (32%) mendojnë se është e rëndësishme që një burrë t’i tregojë partneres së tij se kush udhëheq. Tri nga dhjetë gra (30%) u pajtuan se gratë që thonë se janë abuzuar, shpesh i sajojnë apo i ekzagjerojnë pretendimet për abuzim apo përdhunim. Kjo bindje është më shumë e përhapur në mjediset rurale. Ka mundësi që këto bindje tradicionale të “ndikojnë mbi probabilitetin që gratë të tregojnë se kanë përjetuar dhunë. Megjithatë, me sa duket, këto pikëpamje tradicionale gradualisht ndryshojnë, me ç’rast gratë më të reja kanë shumë më pak gjasa që të kenë bindje patriarkale. Ato madje janë shumë më pak të pranishme

tek gratë me arsim më të lartë dhe tek ato gra që jetojnë në mjedise urbane. Ndërsa pjesa më e madhe e grave janë përgjigjur se shumë pak dinë se çka duhet të bëjnë në rast të dhunës, në realitet janë të vogla gjasat se gratë viktimat të dhunës do të tregojnë ose do ta denoncojnë incidentin në polici ose në organizatë tjetër për mbështetje. Vetëm 2% e grave, të cilat kanë pasur përvoja të kësaj natyre, në të vërtetë e kanë denoncuar në polici atë që ato e kanë konsideruar si incident më serioz. Denoncimi varion varësisht nga kategoria e autorit, me ç'rast gratë që kanë përjetuar dhunë nga personi i cili nuk është partner i tyre ose nga partneri i mëparshëm, ka shumë gjasa se do ta denoncojnë në polici ose në spital incidentin më serioz që u ka ndodhur, në krahasim me gratë që kanë përjetuar dhunë nga partneri aktual. Nuk befason fakti që gratë rrallëherë u drejtohen organizatave lokale për mbështetje të viktimave, duke e marrë parasysh shkallën e ulët të denoncimit dhe informimin përgjithësisht të pamjaftueshëm të grave për këto organizata. Në përputhje me besimin e përhapur në masë të konsiderueshme midis grave, se dhuna në familje duhet të zgjidhet brenda familjes, gratë të cilat nuk i denoncojnë përvojat e tyre në polici, janë përgjigjur se incidenti ka qenë problem familjar: ato më shumë kanë dashur të përballen vet me situatën ose me ndonjë shoqe/mikeshë apo anëtarë të familjes. Gjetjet cilësore vënë në dukje se ekzistojnë shkaqe të ndryshme për një gjë të këtillë, duke e përfshirë edhe mungesën e besimit tek institucionet, ndjenjën e turp-it ose frikës nga reperkusionet eventuale. Përkundër dallimeve të qëndrimeve midis grave më të reja dhe të moshuara, tek gratë e reja nuk ka shumë gjasa se do t'i denoncojnë rastet e dhunës në polici, qoft nga jo-partneri ose nga partneri. Pas incidentit të dhunës, gratë kanë pasur më së shumti nevojë për dikë me të cilin do të mund të bisedonin dhe i cili do mund t'u ofronte mbështetje morale.³⁶

Institucionet shtetërore kanë miratuar Strategjinë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna familjare 2012-2015³⁷, me çka e kanë forcuar kornizën për reagim gjithëpërfshirës të sistemit

³⁶ Ky raport paraqet rezultatet e hulumtimit të kryera nga OSBE-ja për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Maqedoninë e Veriut. Hulumtimi është kryer në vitin 2018 në disa vende të Evropës Juglindore dhe Lindore. Një sondazh i kryer nga OSBE-ja përfshinte komponentat sasiore dhe cilësore dhe është ndërmarrë me qëllim që të sigurojë të dhëna të krahasueshme për format e ndryshme të dhunës që gratë e kanë përjetuar në fëmijërinë dhe gjatë gjithë jetës së tyre. Hulumtimi analizon dhunën që e ndjejnë gratë në zonat të përfshira në konflikte dhe zonat jashtë konflikteve, dhe ndikimin që dhuna ka mbi gratë dhe vajzat, duke përfshirë pasojat e tyre.

³⁷ Strategjinë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna familjare 2012-2015. Strategjia nacionale për parandalim të dhunës në familje 2012-2015 ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv

për pengimin e dhunës familjare në suaza të më shumë resorëve, duke përfshirë edhe shëndetësinë, çështjet sociale, policinë, organizatat joqeveritare dhe aktorë tjerë shoqëror. Për fat të keq, ajo që është shkruar në letër nuk zbatohet edhe në terren. Në të vërtetë, përgjigja e keqe nga sistemi për mbrojtje gjatë vitit të kaluar kontribuojë drejt asaj që të bie motivimi për paraqitje nga ana e viktimave, e cila u arrit përmes punës gjatë viteve të kaluara. Nga kjo mund të konkludohet se sistemi për mbrojtje nga dhuna familjare ka shumë sfida, të cilat institucionet shtetërore duhet t'i shqyrtojnë me më seriozitet.³⁸

Trajtimi i dhunës në familje dhe mekanizmave të cilët duhet të jenë në shërbim të viktimave të tilla³⁹ në Maqedoni bëhet me një model dhe shembull mjaft efikas.

Qendra e parë familjare e Qytetit të Shkupit. Bëhet fjalë për këshillimore të specializuar, që ofron mbështetje psiko-sociale dhe këshillime për familjet që kanë raporte konflikti, ku në mënyrë akute kryhet dhunë ose në periudhën e kaluar ka ekzistuar dhuna familjare. Shërbimet që ofrohen në Qendrën e parë familjare janë:

- Këshillimi dhe mbështetja nga punëtori social;
- Këshillime dhe mbështetje nga psiko-terapeuti;
- Këshillime juridike falas nga juristi;
- Udhëzimi dhe Shoqërimi deri te institucionet këshillëdhënëse;

Këshillimi mund të jetë vullnetar, me kërkesë të klientëve, ndërsa mund të jetë edhe i obliguar, pas shqiptimit të ndonjë mase adekuate. Masat e këtilla janë: masa e përkohshme për mbrojtje në rastet e dhunës familjare, të cilat mund të shqiptohen nga ane gjykatës dhe kanë të bëjnë me: Propozim-masë për vizitë këshillimores dhe Masa e shqiptuar për vizitë këshillimores, të cilat i propozohen, d.m.th. i shqiptohen kryerësit të dhunës familjare.⁴⁰

për parandalim të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë. Përpilimi i këtij dokumenti strategjik në një masë të gjerë mbështetet në Strategjinë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2008-2011 dhe paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të qeverisë së Republikës së Maqedonisë për një zgjidhje funksionale dhe efektive për dhunën në familje.

³⁸ Qendra e Parë Familjare e Qytetit të Shkupit - Ndërprite heshtjen, Lirohu nga dhuna, 2013

³⁹ Shiko më gjerësisht, Komiteti për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, 2002

⁴⁰ Qendra e Parë Familjare e Qytetit të Shkupit - Ndërprite heshtjen, Lirohu nga dhuna, 2013

6.3 KOSOVA

Me qëllim të themelimit të një baze të fortë mbi të cilën mund të bazohet Plani kombëtar i veprimit i Kosovës kundër dhunës në familje⁴¹, Rrjeti i Grupeve të Grave i Kosovës (më tej: RRGGK) ka zhvilluar një hulumtim lidhur me dhunën në familje në Kosovë. RRGGK-ja ka zbatuar një metodologji të përzier, që ka përfshirë mbledhjen e të dhënave statistikore nga institucionet përkatëse, rishqyrtimin e ligjit përkatës, të legjislacionit dhe të shërbimeve sociale në dispozicion; studimin e 1.256 grave dhe burrave të të gjitha moshave dhe grupeve etnike anë e kënd Kosovës; dhe studimin e përfaqësuesve të institucioneve kosovare, të organizatave relevante dhe të ekspertëve. Kosova ka një numër të ligjeve të sofistikuara për të ndjekur penalisht kryerësit e dhunës në familje dhe për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, kodi penal nuk e përkufizon dhunën në familje si krim. Tema nëse ky veprim do të mund të sigurojë ndjekje penale më të mirë dhe më efektive kërkon debat të mëtejshëm. Sot e kësaj dite vërehen problem lidhur me zbatimin e Rregullores mbi dhunën në familje, siç janë vonesat në gjykata lidhur me lëshimin e urdhrit për mbrojtje. Vetëm një numër i vogël i rasteve të dhunës ndiqen penalisht në gjykata, dhe nuk ekzistojnë shënime mbi zbatimin e duhur të sanksioneve që reflektojnë seriozitetin e krimit. Deri tani, janë regjistruar vetëm pak raste të ndjekjes penale për shkeljen e urdhrave të mbrojtës ose për krimet lidhur me lëndimet e lehta trupore të kryera në kuadër të marrëdhënies familjare. Kur prokurori publik “është i gatshëm” të marrë rastet për hetime të mëtejme, përpjekjet e këtilla pengohen nga dosjet e paplota të dorëzuara nga policia, siç janë të dhënat mjekësore, të cilat mund të tregojnë lëndimet trupore. Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare i Kosovës nuk është zbatuar plotësisht. Institucioni përgjegjës për zbatimin e tij, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (më tej: MPMS), ka pasur kapacitete të kufizuara të burimeve njerëzore dhe financiare për të zbatuar plotësisht Ligjin, si dhe për të ofruar ndihmë dhe mbrojtje për viktimat e dhunës në familje. Së këndejmi, MPMS-ja është duke shfrytëzuar shërbimet e organizatave joqeveritare për sigurim të strehimit të viktimave, por financimi i këtyre OJQ-ve është mjaft i kufizuar. MPMS-ja mbulon vetëm 50

⁴¹ Qeveria e Kosovës, përmes përgatitjes, zhvillimit dhe miratimit të “Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje” dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020, shpreh angazhimin serioz dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të fenomenit të dhunës në familje

përqind të shpenzimeve të strehimoreve, duke mos përfshirë personelin ose shpenzimet operacionale. Legjislacioni ekzistues i ndihmës ligjore në Kosovë nuk i parasheh shprehimisht viktimat e dhunës familjare si një kategori me të drejtën për përfaqësim dhe këshillim juridik falas. Avokatët e viktimave janë paraparë për t'u përkujdesur për të drejtat e viktimave, por aktualisht iu mungon kapaciteti i plotë për të bërë këtë. As qendrat shëndetësore e as ekspertët shëndetësorë nuk kanë regjistruar zyrtarisht rastet e dhunës në familje ose nuk e kanë raportuar krimin. Për të përmirësuar përgjigjen multidisiplinare në ndihmën dhe në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje janë të nevojshëm mekanizmat shtetërorë dhe komunalë më të mirë të bashkërenditjes. Aktualisht nuk ekziston një informacion efikas ose shërbim mbështetës për viktimat e dhunës në familje. Linja telefonike DAVA funksionon në mënyrë sporadike dhe përgjigjja e policisë në thirrjet emergjente shpesh është e ngadalshme. Krijimi i një linje konfidenciale, funksionale dhe të papagesë të ndihmës 24 orëshe do të ishte ideale.

Studimi i rastit me 1.256 gra dhe burra ka ilustruar se dhuna në familje ende përgjithësisht konsiderohet si diçka e turpshme në Kosovë, që mund të shpjegojë se përse nuk është e raportuar në përmasat e saj reale. Përafërsisht 40% e të anketuarve janë pajtuar se “Dhuna është një pjesë normale e cilësdo marrëdhënie, dhe shoqëria në përgjithësi, e pranon faktin se herë pas herë dhuna ndodh.” Pothuajse 20 për qind e të anketuarve janë pajtuar se “Ndonjëherë është në rregull që burri ta godas gruan e tij” dhe më shumë se një e treta kanë besuar se “është e natyrshme që dhuna fizike ndodh nganjëherë kur një çift grindet.” Në mënyrë habitëse, dy të tretat e të anketuarve janë pajtuar se “marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë e dhunshme nëse ajo zhvillohet ndërmjet dy të rriturish të cilët janë të martuar.” Shumica e të anketuarve ia atribuojnë sjelljen e dhunshme papunësisë (62.4 për qind) ose alkoolit (43 për qind), dhe besojnë se dhuna ka qenë “normale” ose e pranueshme në rrethana të tilla. Përpjekjet për ngritjen e vetëdijes duhet të çrënjoshin mitet e tilla, duke pasur për cak posaçërisht njerëzit me nivel të ulët të arsimimit, të papunët dhe gratë. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përfunduar nëse dhuna është zvogëluar ose është rritur në Kosovë. Përafërsisht 43% e të gjithë të anketuarve kanë përjetuar dhunë familjare; 46.4% e të gjitha (100%) të grave dhe 39.6% e të gjithë meshkujve.

Krahasuar me grupet e tjera demografike, gratë, njerëzit që jetojnë në zona rurale, të varfrit, të papunët, personat që marrin asistencën sociale dhe njerëzit me më pak se shkollimi i mesëm kanë pasur më shumë gjasa për përjetimin e dhunës. Sipas SHPK-së⁴², 91.1% e kryerësve të dhunës në familje kanë qenë meshkuj, kryesisht burra, dhe vetëm 8.9% kanë qenë gra, edhe pse edhe anëtarë të tjerë të familjes, po ashtu kanë kryer dhunë. Ekzistojnë të dhëna të shumta se dhuna në familje ndikon negativisht mbi individët duke i kontribuar shtimit të problemeve shëndetësore, problemeve psikologjike, paaftësisë për t'u kujdesur për fëmijët dhe, madje, edhe vetëvrasjes ose vdekjes. Sidoqoftë, 14 për qind e të anketuarve nuk mund të gjenin një vend të vetëm, në të cilin dikush që vuan nga dhuna të mund të gjente ndihmën dhe vetëm pak prej tyre dinin lidhur me shërbimet e ofruara nga institucionet, që ilustron nevojën për një shtrirje më të gjerë në kuadër të komunitetit me qëllim të informimit të qytetarëve lidhur me ekzistimin e këtyre shërbimeve. Tani për tani, njerëzit që e përjetojnë dhunën ka më shumë gjasa të kërkojnë ndihmë nga anëtarët e familjes ose miqtë se sa nga institucionet.⁴³

7. FORMAT E PARAQITJES SE DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMEVE MARTESORE

Ekzistojnë disa forma të dhunës në familje dhe një person mund të jetë subjekt i më shumë se një forme të dhunës së tillë. Disa nga këto forma janë:

- a) **Dhuna fizike**- mund të konsistojë në një incident të vetëm ose mund të ndodhë në mënyrë të përsëritur. Përfshin përdorimin e forcës fizike në mënyrë të atillë që lëndon dikë – ose e vë atë person në rrezik lëndimi – përfshirë rrahje, goditje, shkundje, shtyrje, mbytje, kafshime, djegie, shkelmime, ose sulme me armë, kapjen, rrahjen, asfiksimin, pickimin, shpimin, shkuljen e flokëve, përdredhjen e krahut, goditjen me shuplakë, gjuajtjen, djegien, therjen dhe mbytjen. Forma të tjera të abuzimit fizik mund të

⁴² Shërbimi Policor i Kosovës.

⁴³ Hulumtim për hartimin e Strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje, Prishtinë, Kosovë, 2008

përfshijnë izolim ose çdo përdorim tjetër të rrezikshëm apo të dëmshëm force ose shtrëngimi. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë dhe të forcës fizike të një personi, etj. Dhuna fizike shpesh shkakton disa forma dëmtimi ose lëndimi por, mund të shkaktojë edhe vdekje.

- b) Dhuna seksuale**- përfshijnë të gjitha format e agresionit seksual, ngacmimit seksual ose shfrytëzimit seksual. Të detyrosh dikë që të marrë pjesë në veprimtari seksuale të padëshiruar, të pasigurt ose degraduese, ose përdorimi i taktikave poshtëruese ose të tjera për të ulur, kontrolluar ose kufizuar seksualitetin e personave ose zgjedhjet e riprodhimit përbën abuzim seksual. Pra, dhuna seksuale përfshin imponimin, detyrimin ose përpjekjen për të detyruar kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e personit. Abuzimi seksual përfshin, por nuk kufizohet me përdhunimin martesor, sulmet në pjesët seksuale të trupit të viktimës, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimin e personit në mënyrë seksualisht poshtëruese. Abuzimi seksual kryhet nga partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes brenda kontekstit të martesës, të marrëdhënieve dashurore dhe të familjes.
- c) Dhuna ekonomike**- përfshin vjedhjen ose mashtrimin e partnerit. Mosdhënia e parave që janë të domosdoshme për të blerë ushqim apo trajtim mjekësor, shfrytëzimi i një personi për përfitim financiar, mohimi i aksesit për burime financiare, ose pengimi i një partneri që të punojë gjithashtu forma të abuzimit ekonomik.
- d) Dhuna psikologjike**- përfshin sulme verbale, si bërtitje, këlthitje, fyerje (etiketime), izolim nga shoqëria, ose frikësim. Kanosje për dhunë dhe për marrje të fëmijëve janë taktika mjaft të përhapura të përdorura nga dhunuesit, si dhe dëmtimi i zotërimeve apo kafshëve të viktimës.⁴⁴ Ky lloj dhune manifestohet në formë të:
- **Abuzimit emocional:** shkatërrimi i ndjenjës së vetëvlerësimit dhe/ose të vetëbesimit të një individi. Kjo mund të përfshijë kritikimin e vazhdueshëm, poshtërimin, përçmimin e

⁴⁴ Manual i OSBE-së në Shqipëri, Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje, 2013.

aftësive të një personi, sharjet, degradimin dhe dëmtimin e marrëdhënieve të dikujt me fëmijët e tij ose të saj.

- **Abuzimit psikologjik:** përfshin shkaktimin e frikës nëpërmjet trembjes; kërcënimin për dëmtim fizik të vetes, partnerit, fëmijëve ose të familjes së partnerit apo të miqve; kërcënimin për braktisje; vrasjen e kafshëve shtëpiake dhe shkatërrimin e pronës; kërcënimet për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve; izolimin e dhunshëm nga familja, miqtë, shkolla dhe/ose puna dhe mohimin e mundësisë për para ose mbështetje ekonomike.

- e) **Dhuna seksuale:** kjo formë e dhunës përfshinë detyrimin, imponimin, si dhe përpjekjen për të imponuar sjelljen seksuale pa pëlqimin e viktimës. Abuzimi seksual përfshinë, por nuk kufizohet vetëm në përdhunimin martesor, imponimin për të bërë seks, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimin e personit në mënyrë seksualisht poshtëruese. Abuzimi seksual kryhet nga partnerët intim dhe nga anëtarët e familjes brenda raporteve martesore, etj.

KAPITULLI II

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË SHFAQJEN E DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMET MARTESORE

Në shfaqjen e dukurisë së dhunës në familje dhe krimeve martesore ndikojnë një numër faktorësh që determinojnë shfaqjen e kësaj dukurie dhe të cilat na japin një pasqyrim më të qartë lidhur me këtë lloj krimi. Disa nga faktorët që ndikojnë në shfaqjen e dhunës në familje dhe krimeve martesore janë:

1. Niveli i ulët i vetëdijes dhe emancipimit

Reagimi përgjithësisht i dobët i sistemit të drejtësisë penale, mungesa e vetëdijes së viktimave për raportimin në kohë të krimeve të dhunimit dhe besimi i ulët në sistemin e drejtësisë ka çuar në raportimin e ulët të rasteve të dhunimit në Kosovë. Rrjedhimisht, gjatë periudhës së monitoruar 2015-2018 ka pasur vetëm 15 raste të raportuara të krimit të dhunimit në Kosovë.

Situata është përkeqësuar më tej për shkak të mungesës së besimit të qytetarëve të Kosovës në sistemin gjyqësor. Në vitin 2016 vetëm 5% e kosovarëve janë në përgjithësi të kënaqur me policinë, prokuroritë, gjykatat, EULEX-in dhe Qeverinë. Në vitin 2016 një studim përfaqësues me 1097 anketues në tërë Kosovën ka treguar se më shumë se një e treta e të gjithë të anketuarve perceptojnë se gjykatat e Kosovës (34.28%) ose prokuroria (31.09%) më së shumti kërkojnë ose pranojnë ryshfet. Ndryshe, besimi në shërbimin e Policisë së Kosovës është më i lartë. Përkeqësimi ekzistues i sistemit të sundimit të ligjit mund të lejojë ngritjen e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, duke u pasuar nga një kulturë e mosndëshkimit, ku autorët e krimit nuk përballen me pasoja shoqërore ose ligjore.⁴⁵

Të anketuarit nga institucionet e ndryshme të intervistuar ishin të prirë të pajtohen se që nga viti 2008, në mesin e qytetarëve dhe institucioneve, është përmirësuar vetëdijesimi në lidhje me dhunën në familje, të paktën pjesërisht. Të tjerët nuk pajtoheshin, duke menduar se njerëzit

⁴⁵ Qosaj-Mustafa, A., & Morina, M. veper e cituar.

akoma nuk e kuptojnë dhunën në familje dhe format e saj të ndryshme. Disa të intervistuar shprehën shqetësimin se grupeve të caktuara demografike, siç janë gratë dhe personat me aftësi të kufizuara, u mungon vetëdija dhe njohuritë në lidhje me dhunën në familje. Përderisa këto gjetje janë të bazuara në përshtypje të institucioneve, kjo pjesë shqyrton rezultatet aktuale të studimit në mbarë Kosovën, duke siguruar informata më të sakta në lidhje me vetëdijesimin e qytetarëve dhe qëndrimet ndaj dhunës në familje. Të dhënat e studimit tregojnë se situata është përkeqësuar në atë se 21.1% e kosovarëve besojnë se “nganjëherë është në rregull që një burrë ta godasë gruan e tij”, në krahasim me 18.7% në vitin 2008. Siç ilustron Grafiku 1, në mesin e personave të gjinive të ndryshme kanë ndodhur ndryshime të vogla. Në vitin 2015, një përqindje pak më e lartë e burrave pajtohen apo deri diku pajtohen (20,1%), se është në rregull që një burrë ta godasë gruan e tij, në krahasim me vitin 2008 (16.9%).⁹² Në të njëjtën kohë, përqindja e njerëzve që nuk pajtohen apo deri diku nuk pajtohen me këtë deklaratë ka rënë nga 83.3% në 2008 në 77.6% në vitin 2015. Për më tepër, 22% e grave pajtohen apo deri diku pajtohen se është në rregull që një burrë ta godasë ndonjëherë gruan e tij. Ndryshe nga burrat, perceptimet e grave kanë mbetur mjaft të qëndrueshme me kalimin e kohës. ⁹³ Kjo gjetje në fjalë sugjeron një potencial në rritje për dhunë në mesin e burrave.⁴⁶

Shkalla e ulët e ndërgjegjësimit të ofruesve të shërbimeve Punonjësit e shëndetësisë, QPS, sistemit të drejtësisë dhe arsimit janë ndër njerëzit të cilët mund të ndryshojnë dhe të shpëtojnë jetët në rrezik të pacientëve / viktimat të dhunës në familje. Ofruesit e shërbimeve në këto fusha e kanë potencialin për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar viktimat e dhunës, por atyre iu mungojnë ndërgjegjësimi dhe shprehitë bazë për të kapërcyer barrierat personale ndaj çështjes së dhunës në familje. Mungesa e ndërgjegjësimit të institucioneve shtetërore në përgjithësi shpjegon edhe mungesën e ndërgjegjësimit të ofruesve të shërbimeve që ndërveprojnë drejtpërdrejt me viktimat e dhunës në familje. Strukturat apo individët prej të cilëve priten ndryshimet nuk ekzistojnë në vakum, ato mbështeten në kontekstin patriarkal që dikton reagimet pranuese të dhunës në familje.⁴⁷

⁴⁶ Farnsworth, N., vepër e cituar.

⁴⁷ Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimtimit 2011-2014

Mungesa e vetëdijes nga viktimat, opinioni publik, por edhe nga ofruesit e shërbimeve pengon aftësinë e institucioneve kosovare për të mbrojtur dhe ndihmuar viktimat e dhunës në familje. Rrethanat personale të viktimës së dhunës në familje mund të paraqesin sfida për ofrimin dhe pranimin e shërbimeve për një viktimë. Te viktimat vërehet ndjeshmëria emocionale, ndjenja e humbjes së sigurisë financiare, frika nga sistemi shumë i komplikuar, kompromitues dhe i stërzgatur, pasiguri dhe mundësi e viktimizimit sekondar. Problemet hasen në rastet kur viktima vie nga mjedise jofunksionale dhe të cilat mjedise duhet të përmirësohen para fazës së reintegrimit të tyre.⁴⁸

2. Gjendja e vështirë ekonomike

Kosova është një ndër shtetet me një ekonomi më të pazhvilluar në Evropë. Niveli i lartë i papunësisë, ku 1/3 e popullsisë jeton në nivelin e kufirit të varfërisë dhe një në tetë vetë jetojnë në varfëri ekstreme. Me gjithë përmirësimet graduale, nga viti 2008, përkundër shpalljes së pavarësisë, Kosova për shkak të problemeve politike, me një status të kontestueshëm nga disa shtete të BE-së, ka pasur investime jo të mjaftueshme ekonomike nga shtetet evropiane. Gjithashu, varësia nga ndihmat e huaja dhe dërgesat nga jashtë dhe imigrimi jashtë vendit në numër të madh – të gjitha këto kanë qenë pengesa për një rritje të shpejtë ekonomike.

Krahasuar me vendet fqinje dhe ato evropiane, Kosova ka mbetur prapa përse i përket cilësisë dhe aksesit ndaj arsimit, mbulimit me kujdes shëndetësor dhe standardeve të jetesës. Përkundër të gjitha problemeve evidente, Kosova ka avancuar në fushën e barazisë gjinore.⁴⁹ Nga tërë kjo mund të konkludohet se gjendja socio-ekonomike e grave, fëmijëve dhe të

⁴⁸ Agjencia për Barazi Gjinore, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë bazuar në Programin e Kosovës kundër dhunës në familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014

⁴⁹ Krol, K., (2017), Krijimi i hartës së shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë, Projekti i Këshillit të Evropës, "Forcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë".

moshuarve i bën ata tradicionalisht të varur nga anëtarët tjerë të familjes dhe për rrjedhojë edhe më të cënuar nga dhuna.⁵⁰

3. Masediat

Roli i masmediave (TV dhe radiove, portaleve elektronike) dhe i gazetarëve është i rëndësishëm në fushën e informimit dhe edukimit të opinionit publik për çështje të ndryshme sociale, ndërsa media është pasqyra përmes së cilës publiku informohet dhe krijon pikëpamjet e veta mbi dhunën në familje dhe dhunën seksuale në një shoqëri.

Lidhur me informatat e masmediave mbi dhunën në familje gjatë viteve të fundit vërehet se shumica e lajmeve janë raportuar duke u fokusuar në ngjarje që në dukje janë të izoluara, në vend që të raportohen në kuadrin e një problemi shoqëror. Kurse, sa i përket lajmeve të dhunës seksuale, thuaja për këto fare nuk shkruhet dhe nuk informohet opinion publik, përkundër asaj se dukuria e tillë është e evidente.

Rastet e dhunës në familje dhe dhunës seksuale janë krime të rënda dhe kanë jehonë të madhe në opinionin publik. Masediat janë institucione me rëndësi për informimin e opinionit publik mbi prezencën e këtyre dukurive dhe njëherit janë shumë të rëndësishme që para institucioneve dhe opinionit publik ta hapin debatin për prezencën e këtyre llojeve të krimeve, që atakojnë jo vetëm familjen por edhe shoqërinë në përgjithësi. Kjo është arsyeja që masediat duhet të luajnë një rol aktiv në plasimin e ngjarjeve si: plagosjet dhe vrasjet si pasojë e dhunës në familje, aktet e dhunës seksuale, pedofilia, incesti, etj,

Masediat poashtu, duhet ta respektojnë etikën e informimit dhe atë gazetareske me rastin e plasimit të informatave të tilla meqenëse këto godasin rëndë vetëdijen e qytetarëve - opinionit publik dhe mund të shkaktojnë efekte negative psikologjike sidomos tek fëmijët dhe tek të rinjtë. Hulumtimet e bëra tregojnë se aktet e dhunës seksuale në Kosovë parimisht kryhen nga personat e njohur për viktimën dhe kryesin e krimit të tillë, duke mos përjashtuar se ka mjaftë

⁵⁰ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020, Prishtinë, Maj 2016

raste kur këtë e kryejnë jo vetëm personat e largët familjarisht, por edhe anëtarët e familjes. Kjo është arsyeja që në mjaftë raste viktimat e krimit të tillë nuk i lajmërojnë rastet e tilla në policinë e Kosovës dhe institucionet tjera kompetente, gjithnjë nga frika e turpfit shoqëror, familjar, miqësor dhe më gjerë.

Eshte obligim i masmediave që me rastin e raportimit të krimeve të tilla ta ruajnë identitetin e viktimës së përdhunuar seksualisht, pasi në të kundërtën, mund të ketë efekte të rënda për personalitetin, shëndetin mental dhe emocional të viktimës. Pra, gjatë raportimit të lajmeve mbi dhunën në familje dhe krimet martesore, masmediat duhet t'i japin përparësi të drejtave të viktimave për dinjitetin, privatësinë, konfidencialitetin, besimin, sigurinë dhe mbrojtjen nga dëmet e shkaktuara nga masmediat dhe opinion publik. Përdorimi i pamjeve për të pasqyruar dhunën në familje është mjaft i ndërlikuar. Obligim profesional i stafit në masmedia është që me rastin e plasimit të rasteve konkrete lidhur me dhunën në familje dhe krimet martesore të mos përfshijnë asnjë informacion i cili do t'i identifikonte plotësisht viktimat e këtij lloji të krimit. Përveç rasteve kur të mbijetuarit kanë dhënë pëlqimin e tyre, fotot nuk duhet të përfshijnë asnjë informacion identifikues. Çdo përdorim i imazheve duhet ta paraqesë subjektin në një mënyrë që e ruan dinjitetin e tyre. Fotot e të mbijetuarve fëmijë nuk duhet të përdoren kurrë. Është obligim i gazetarëve hulumtues që ngjarjet mbi format e ndryshme të dhunës seksuale me saktësi ta paraqes natyrën e dhunshme të sulmit seksual, të raportojë mbi dëshminë e viktimës, mbi mungesën e pëlqimit, ose të sigurohet që të ketë informacion të konsiderueshëm nga avokati ose mbështetësi i viktimës.⁵¹

⁵¹ Ura,H., (2018), Raportimi në media i çështjeve të dhunës në familje dhe dhunës seksuale, Gazeta Nisma, Tiranë.

4. Mosefikasiteti i zbatimit të ligjeve

Një ndër faktorët relevant që ndikojnë në shfaqjen e dhunës në familje dhe krimeve martesore dhe që kanë efekte negative në rritjen e numrit të kësaj dukurie kriminale është edhe mosefikasiteti i zbatimit të ligjeve nga ana e institucioneve kompetente shtetërore.

Në krahasim me numrin aktual të rasteve, dhuna në familje në Kosovë mbetet pak e raportuar në institucionet kompetente shtetërore. Faktorë të ndryshëm vazhdojnë të çojnë në reagime joadekuate ndaj rasteve të dhunës në familje. Lëshimi i urdhrave të mbrojtjes për viktimat që kërkojnë mbrojtje është përmirësuar në vitet e fundit; megjithatë, policia dështojnë të bëjnë vlerësime të rregullta dhe të vlefshme për rrezikun gjatë edhe pas lëshimit të urdhrave të mbrojtjes. Mungesa e vlerësimit të rrezikut për abuzimet sistematike në rastet e dhunës në familje ka çuar në pasoja tragjike si në rastin e vrasjes së Valbona Marku-Nrecajt dhe vajzës së saj 9-vjeçare në gusht të vitit 2018.

Reagimi i gjyqësorit ndaj akteve të dhunës në familje ende mbetet i dobët, derisa edhe rastet të hedhura poshtë të dhunës në familje mbetet në nivel të lartë. Sistemi i drejtësisë i Kosovës vazhdon të përballet me sfida sistematike, duke bërë që viktimat e dhunës në baza gjinore të jenë më të ndjeshme ndaj ofrimit të drejtësisë joefektive. Shumë prej këtyre sfidave rezultojnë nga fakti se Kosova është ende në fazat e fillimit të zhvillimit të një sistemi gjyqësor të mirëfillt. Fakti se në gjykatat e Kosovës janë grumbulluar mbi 200.000 lëndë të pazgjidhura, tregon për një sistem gjyqësorë të brishtë, e që ka refleksione negative edhe në këtë lloj të krimit.

Gjatë vitit 2017, ka pasur gjithsej 1,277 raste të raportuara të dhunës në familje pranë Policisë së Kosovës⁵². Në nivel global konsiderohet se një në çdo tre gra përjeton dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri i saj dhe një në çdo dhjetë gra kanë përjetuar marrëdhënie të dhunshme ose akte të tjera abuzimi në një moment gjatë jetës së tyre. Fatkeqësisht, rastet e raportuara të dhunës në familje në Kosovë mbeten të ulëta krahasuar me incidentet aktuale të akteve të dhunshme të raportuara kundër grave. Siç është thënë, në vitin 2015, 68% e grave të intervistuar kishin raportuar se kishin përjetuar një formë të abuzimit në familje të ushtruar kundër tyre në shtëpitë e tyre. Duke qenë se nuk ka një bazë të dhënash unike për mbledhjen

⁵² Raportet Zyrtare të Policisë së Kosovës për periudhën 2015 -2017. <https://www.kosovopolic.com/> dt.01.04.2020, ora 00:15.

dhe ndjekjen e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve gjyqësore për rastet e dhunës në familje në Kosovë, është e vështirë të matet numri i saktë i rasteve të proceduara brenda të njëjtit vit. Sipas të dhënave të Policisë në 15 vitet e fundit të raportimit të dhunës në familje, çdo vit raportohen afërsisht 1,000 deri në 1,200 raste. Kërkesat për paraburgim në rastet e dhunës në familje janë tepër të ulëta. Prej 2,959 kallëzimeve penale në vitin 2016, prokuroria ka bërë vetëm 84 kërkesa për paraburgim (2,8%). Në 2017, paraburgimi u kërkua vetëm në 115 raste (11.3%) dhe në gjysmën e parë të vitit 2018, paraburgimi u kërkua vetëm në 69 raste (5.5%). Efektet e lirimit të autorëve të krimit, gjë që shpesh përcillet me presion kundër viktimës në shtëpitë e familjeve të tyre, kanë shpjerë viktimat shpesh drejt tërheqjes së deklaratave të tyre dhe ndjekjes penale të akteve të dhunës në familje. Për më tepër, mbështetja e përgjithshme e prokurorëve mbi deklaratat e viktimave, si dhe tërheqja e mëvonshme e viktimës nga prokuroria, kontribuon në numrin e madh të rasteve të hedhura poshtë çdo vit në gjykatë. Numri i kallëzimeve penale që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje të cilat janë hedhur poshtë ose janë refuzuar me aktgjykime refuzimi vazhdojnë të jenë alarmante. Në vitin 2017, mbi gjysma e të gjitha kallëzimeve penale lidhur me rastet e dhunës në familje ishin hedhur poshtë (51.6%). Në anën tjetër, aktgjykimet refuzuese mund të vijnë si rezultat i tërheqjes së aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Gjatë vitit 2016 ka pasur 94 aktgjykime refuzuese, 62 në vitin 2017 dhe 20 në gjysmën e parë të vitit 2018.⁵³

Një nga problemet që haset në Republikën e Kosovës është edhe kulifikimi i gabuar i veprave penale në përgjithësi, e në veqanti ato që kanë të bëjnë me dhunën familjare. Kjo shpeshherë bëhet edhe qëllimshëm nga prokurorët për shkak të procedurave të mëutjshme por edhe shkaqe të tjera objektive dhe subjektive.

Dështimi për të kategorizuar rastet e dhunës në familje në mënyrë adekuate. Në vitin 2011, tre ditë pas martesës, Antigona Morina kishte vdekur për shkak të gjakderdhjes së madhe. Edhe përkundër faktit se ajo kishte filluar të gjakos në natën e martesës së saj, burri i Antigonës kishte vazhduar të kryej marrëdhënie seksuale të dhunshme me të dhe nuk kishte arritur që ta

⁵³ Raportet Zyrtare nga Institucionet Gjyqësore të Republikës së Kosovës për periudhën e raportuar 2015 – 2018. Për vitin 2019 shënimet statistikore ende nuk janë direkt të çastshme, në mënyrë që ti inkorporoj në punimin e tillë, si pjesë e hulumtimit, si pasojë e pandemisë globale. <https://prokuroria-rks.org/> <https://ëëë.gjygesori-rks.org/>

dërgojë tek ndonjë mjek profesionist. Në vend të kësaj, ajo ishte dërgua tek një sheh, i cili ofronte terapi tradicionale. Pas vdekjes së Antigonës, prokuroria ngriti padi penale kundër bashkëshortit të saj në pajtim me nenin 251 të Kodit Penal, mbi "Shkeljet e Detyrimeve Familjare". Ai u shpall i pafajshëm nga Gjykata Themelore e Gjakovës (Dega në Rahovec). Megjithatë, ankesa e parashtruar nga prokuroria kishte humbur dhe asnjëherë nuk kishte arritur në Gjykatën e Apelit. Pretendohet se gjyqtari në detyrë (i cili tani është i pensionuar) e kishte fshehur ankesën qëllimshëm. Për shkak të presionit nga mediat, aktivistet e grave dhe OSHC-të, prokuroria ri-dërgon ankesën në fillim të vitit 2018. Rrjeti i Grave të Kosovës ka punësuar një avokat për të përfaqësuar familjen e Antigonës gjatë procesit të apelit.

Në rastin e Antigonës, dështimi për të kualifikuar drejtpërsëdrejti veprën penale dhe lëndimet e shaktuara ndaj trupit të saj (i cili u pranua edhe nga Raporti Mjekësor i Mjekësisë Ligjore), çoi në trajtimin jo të duhur të çështjes nga ana e gjykatave. Sipas kushteve të përcaktuara në Konventën e Stambollit, shtetet duhet të veprojnë në përputhje me rëndësinë e akteve të kryera kundër grave. Zvogëlimi i akteve të dhunës kundër grave apo edhe kualifikimi i gabuar i akteve të dhunës në familje janë taktika që shpesh përdoren nga sistemi gjyqësor me qëllim të nxjerrjes së dënimeve minimale në rastet e dhunës në familje (përfshirë edhe dhënien e gjobave, caktimin e dënimit me kusht apo edhe periudhën provuese).

Përveç kësaj, reagimi gjyqësor mbetet i dobët. Çdo vit, ka disa raste që nuk gjykohen për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit. Sipas të dhënave të dorëzuara në KIPRED nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, në vitin 2015, 18 raste nuk janë gjykuar për shkak të parashkrimit. Për më tepër, në vitin 2016, 28 raste nuk janë gjykuar dhe në vitin 2017, 15 nuk janë gjykuar⁵⁴. Reagimi i ngadaltë e gjyqësorit përkeqëson më tej mosndëshkimin ekzistues të autorëve të krimit. Për më tepër, Konventa e Stambollit kërkon nga shtetet që të krijojnë programe parandaluese dhe trajtuese për autorët e krimit. Në përputhje me Konventën, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje parasheh trajtim dhe trajtim psiko-social nga varësia nga substancat psikotrope dhe alkooli. Këto programe rregullohen më tej nga dy Udhëzime

⁵⁴ Raportet zyrtare nga institucionet gjyqësore të Republikës së Kosovës për periudhën e raportuar 2015 – 2018. Për vitin 2019 shenimet statistikore ende nuk janë të çastshme, në mënyrë që ti inkorporoj në punimin e tillë, si pjesë e hulumtimit.

Administrative, njëri mbi trajtimin psikosocial, dhe tjetri në lidhje me trajtimin e alkoolizmit dhe substancave të tjera. Këto dy udhëzime janë kritikuar për shkak se sugjerojnë në mënyrë indirekte se sjellja psiko-sociale dhe varësia janë shkaqet rrënjësore të dhunës në familje. Megjithatë, gjetjet e KIPRED kanë treguar se këto udhëzime janë të rralla dhe thuajse fare të pa zbatuara. Vetëm 17 masa për trajtim të detyrueshëm ishin urdhëruar në vitin 2016, 11 në vitin 2017 dhe 8 në gjysmën e parë të vitit 2018⁵⁵. Rastet e veprave penale kundër martesës dhe familjes njëjtë si për rastet tjera të trajtuara deri më tani, edhe për veprat penale kundër martesës dhe familjes fillimisht janë përfshirë rastet në prokurori për vitet 2015 dhe 2016, më pas janë trajtuar të njëjtat të proceduara në Gjykatat Themelore. Rastet me persona në të gjitha prokuroritë të cilat janë proceduar gjatë vitit 2015: Nga gjithsej 92 raste me 123 persona të cilat kishin në punë prokuroritë gjatë vitit 2015, 46 raste me 55 persona ishin bartur nga viti paraprak (2014) derisa ishin pranuar 46 raste me 68 persona, ndërsa ishin zgjidhur 37 raste me 50 persona. Sipas statistikës së tillë, del të jenë pranuar më shumë raste gjatë vitit 2015, sesa janë zgjidhur rastet e tilla nga prokuroritë për periudhën e njëjtë, duke rënduar kështu gjendjen e prokurorisë me numrin e lëndëve. Bazuar në statistikat e KPK-së⁵⁶, në fund të vitit 2015 (31 dhjetor), prokuroritë kishin në punë 55 raste me 73 persona. Ndryshe nga viti 2015, gjatë vitit 2016, prokuroritë kishin zgjidhur më shumë raste, përkatësisht 53 të tilla me 61 persona. Në tabelën në vijim, janë përfshirë rastet me persona në të gjitha prokuroritë të cilat janë proceduar në vitin 2016.⁵⁷

Bazuar në të dhënat e siguruar në KGJK⁵⁸, gjykatat posedojnë më shumë raste të veprave penale kundër martesës dhe familjes krahasuar me rastet e njëjta në prokurori.

Kosova posedon një varg dispozitash të cilat parashohin të gjitha rastet e dhunës në familje dhe krimeve martesore. Kushtetuta⁵⁹ e Republikës së Kosovës me kapitullin 2 të saj, parasheh të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe që në një formë ose tjetrën në rastet e dhunës në

⁵⁵ Qosaj-Mustafa, A. & Morina, M. (2018), Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit, OJQ KIPRED, fq.29

⁵⁶ Shenime nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për periudhën e raportuar.

⁵⁷ Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu, Qasja në drejtësi dhe të drejtat e njeriut, 2016 – 2017

⁵⁸ Shenime nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për periudhën e raportuar.

⁵⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, s hyn në fuqi më 15 qershor 2008

familje dhe krimeve martesore cenohen. Këto të drejtat janë: diinjteti i njerluta, barazia para ligjit, e drejta për jetën, e drejta e integritetit personal.⁶⁰

Kodi Penal i Kosovës⁶¹ ka kapitull të veçantë për veprat penale kundër martesës dhe familjes. Veprat që parashihen në këtë kod janë: keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (neni 243), shkelja e detyrimeve familjare (neni 244), shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës (neni 245), pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve (neni 246), mos raportimi i abuzimit të fëmijëve (neni 247), dhuna në familje (neni 248).⁶²

Ky kod poashtu në nenin e dhunës në familje parg 2. Përcakton se kur çfarëdo vepre në Kodin Penal kryhet brenda marëdhënies familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese.

Këto vepra mund të jenë: vrasja (neni 172), vrasja e rëndë (173)- privon nga jeta fëmijën, femrën shtatzënë, anëtarin e familjes, personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake, privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave të tjerë. Kanosja (neni 181), lëndimi i lehtë trupor (neni 185), lëndimi i rëndë trupor (neni 186), dhunimi (neni 227), degradimi i integritetit seksual (neni 230). Poashtu, edhe Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje përmban mjaftë dispozita lidhur me masat mbrojtëse në nenet 4,5,6,7,8,9,10,11.⁶³

Kosova ka edhe “Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje” dhe Planin e Veprimit 2016– 2020.⁶⁴ I cili është konceptuar si një udhërrëfyes drejt një shoqërie pa dhunë, ku të gjithë anëtarët e familjes të mund të jetojnë të qetë dhe të lumtur duke u ndier të mbrojtur në një mjedis të sigurtë; ku gratë respektohen, mbrohen dhe mbështeten për të ecur përpara; ku fëmijët vajza dhe djem, rriten të lumtur mes parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit; ku të moshuarit në familje mbrohen dhe respektohen; ku individët me nevoja të veçanta ndjehen njëlloj pjesë e familjes dhe trajtohen me kujdes dhe prioritet; ku cilido anëtar në familje mirëpritet dhe gëzon mbrojtje dhe dinjitet pavarësisht

⁶⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, s hyn në fuqi më 15 qershor 2008

⁶¹ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës

⁶² Po aty.

⁶³ Ligji nr. 03/I-182 Për Mbrojtje nga Dhuna në Familje i Rep.Kosoves

⁶⁴ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020, Prishtinë, maj 2016

orientimit seksual - pra një shoqëri që ka për bazë një familje të shëndoshë që mbron, respekton dhe trajton me përparësi nevojat e cilitdo anëtar të saj, pa asnjë dallim.

Në krahasim me numrin aktual të incidenteve, dhuna në familje në Kosovë mbetet pak e raportuar. Faktorë të ndryshëm vazhdojnë të çojnë në reagime joadekuate ndaj rasteve të dhunës në familje. Lëshimi i urdhrave të mbrojtjes për viktimat që kërkojnë mbrojtje është përmirësuar në vitet e fundit; megjithatë, policia dështojnë të bëjnë vlerësime të rregullta dhe të vlefshme për rrezikun gjatë edhe pas lëshimit të urdhrave të mbrojtjes.

Mungesa e vlerësimit të rrezikut për abuzimet sistematike në rastet e dhunës në familje ka çuar në pasoja tragjike si në rastin e vrasjes së Valbona Marku-Nrecajt⁶⁵ dhe vajzës së saj 9-vjeçare në gusht të vitit 2018.

Reagimi i gjyqësorit ndaj akteve të dhunës në familje mbetet i dobët. Norma e rasteve të hedhura poshtë të dhunës në familje mbetet e lartë, pasi gjatë vitit 2017 ishin më shumë se gjysma e të gjitha kallëzimeve penale të lidhura me rastet e dhunës në familje (51.5%) që ishin hedhur poshtë nga gjykatat e Kosovës. Për më tepër, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, u hodhën poshtë gjithsej 15.1% raste. Për periudhën e monitoruar për 2015-2018, vetëm 40.4% e rasteve kanë marrë vendime të fajësisë. Kjo përgjigje e ngadaltë nga sistemi i drejtësisë penale ndaj rasteve të dhunës në familje ka çuar në shfaqjen e përgjithshme të mosndëshkimit për autorët e dhunës në familje. Për më tepër, viktimat që fajësohet dhe pajtimi i viktimës me kryerësin mbetet e zakonshme në mesin e të gjitha institucioneve të monitoruara, shpesh të justifikuara me qëllim të "shpëtimit" të familjes tradicionale.

Në rastet kur viktimat nuk duan të raportojnë dhunimin menjëherë, nuk ka asnjë mjet për të ruajtur provat mjeko-ligjore pasi që Kosova nuk ka sisteme të specializuara mbështetëse për viktimat e dhunimit, siç janë Qendrat e Krizave të Dhunimit dhe Qendrat e Referimit Seksual.⁶⁶ Të dhënat institucionale ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për të monitoruar mbizotërimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, sepse nuk ekziston një mekanizëm institucional për të

⁶⁵ <https://kallxo.com/ligji/gjykata/pjeter-ndrecaj-i-denuari-me-burgim-te-perjetshem-serish-para-gjykates/e> shikuar me 10.5.2020

⁶⁶ Qosaj-Mustafa, A & Morina, D., (2018) Raport i Politikave: Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi I mosndëshkimit të autorëve të krimin, Kosovar Institute for Policy Research and Development.

përcjellë rastet e hetuara, ndjekur penalisht dhe gjykuar nga gjykatat (duke përfshirë ndjekjen e praktikave të dënimit brenda gjykatave). Gjithashtu nuk ka të dhëna të ndara mbi krimet e dhunës në baza gjinore që mund të përdoren për të identifikuar se sa vrasje në Kosovë janë kryer si rezultat i marrëdhënieve familjare. Raporte të tjera tregojnë se dhuna me bazë gjinore mbetet e përhapur dhe nuk adresohet në mënyrë të mjaftueshme nga institucionet e drejtësisë.⁶⁷

Sistemi i drejtësisë i Kosovës vazhdon të përballet me sfida sistematike, duke bërë që viktimat e dhunës në baza gjinore të jenë më të ndjeshme ndaj ofrimit të drejtësisë joefektive. Shumë prej këtyre sfidave rezultojnë nga fakti se Kosova është ende në fazat e fillimit të zhvillimit të një sistemi gjyqësor funksional. Tanimë për më shumë se një dekadë, gjykatat e Kosovës janë ballafaquar me një grumbull të lëndëve të pazgjidhura gjë që e ka vonuar drejtësinë për viktimat dhe palët e tjera të përfshira. Për më tepër korrupsioni në nivel të lartë mbetet shumë i zgjeruar dhe kjo shpije drejt mos efikasitetit të përgjithshëm të sistemit të drejtësisë. Edhe pse është bërë progres në luftën kundër korrupsionit gjatë viteve të fundit, ende ka nevojë për masa gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit. Kosova, së bashku me vendet e tjera në rajonin e Ballkanit janë identifikuar si "shtet i kapur" duke përfshirë këtu edhe mungesën e një sistemi të pavarur dhe efikas të gjyqësorit. Për më tepër, gjyqësori mbetet me prirje të jetë i ndikuar nga politika dhe joefikasitetit, duke ndikuar më tej në cilësinë e sistemit të drejtësisë⁶⁸

Një ndër problemet që kanë ndikim negative në tërë këtë çështje është se kemi arsyetim jo të kënaqshëm - të varfër të aktvendimeve me të cilat shqiptohen urdhrat mbrojtës. Arsyetimet e vendimeve gjyqësore rezultojnë të jenë të cekëta, pa ndonjë analizë të qartë të faktit kriminal, dhe të shkaqeve të kryerjes së veprës kriminale - penale. Nga vendimet ndodh që të mos kuptohet thelbi dhe shkaku, dhe motivet e dhunës. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka raportuar më parë se aktgjykimet e gjykatave në kontestet civile shpesh nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm, gjë që shkel ligjin procedural dhe mund të shërbej si bazë për ankesë. Ndërkohë, është e domosdoshme që për efektivitetin e mbrojtjes së ushtruar prej avokatëve të

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Po aty.

minimizohen ose eliminohen probleme që kanë të bëjnë me etikën profesionale të tilla si: heqja dorë nga mbrojtja gjatë procesit, mungesa e profesionalizmit, mosparaqitja në seanca të ndryshme gjyqësore, zvarritjet, etj.

Në mosefikasitetin e zbatimit të ligjeve efekte negative kanë edhe:

- Kapacitetet e kufizuara profesionale kushtuar çështjeve gjyqësore të dhunës në familje;
- Besimi i kufizuar i qytetarëve në sistemin gjyqësor;
- Mungesa e raportimit të dhunës ndaj fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar, etj.⁶⁹

5. Papunësia

Një lidhje të ngushtë me problematikën e dhunës në familje dhe krimet martesore ka edhe papunësia e njërit apo të dy bashkëshortëve. Ky problem është mjaft evident në Kosovë kur dihet se dominon një papunësi e madhe në të gjithë sektorët e jetës ekonomike. Në këtë ka ndikuar edhe mos investimi i kapitali të huaj, krizat e shpeshta politike, masat ekonomike jo efikase për hapjen e vendeve të reja të punës, etj. Gjithë këta faktorë e determinojnë përkeqësimin e raporteve bashkëshortore brenda familjes, gjë që ka për refleksion edhe përkeqësimin e raportit të tyre deri në masën e shprehjes së dhunës në familje nga njëri apo tjetri bashkëshort. Një përkeqësim i tillë i raporteve familjare për shkak të papunësisë ka reflektime negative edhe te anëtarët e tjerë të bashkësisë familjare, konkretisht fëmijëve ndaj të cilëve bashkëshortët nuk mund ti përmbushin obligimet elementare për jetesë. Për ta zbutur, gjegjësisht eliminuar në masë të madhe këtë faktor që ndikon në shfaqjen e dhunës në familje dhe krimeve martesore, insitucionet shtetërore kosovare duhet të hartojnë plane të veprimit afatgjat në sferën e zbutjes së papunësisë.

Të dhënat e Agjencisë Statistike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ASK), për periudhën e hulumtuar, ka treguar se shkalla e papunësisë në Kosovës është 30.2 për qind.

⁶⁹ Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

Anketa e cila ka pasur shtrirje në 600 qarqe regjistruese në tërë territorin e Kosovës dhe ku janë anketuar 3 mijë e 630 ekonomi familjare, tregon se papunësia më e theksuar është te femrat më 38.0 për qind krahasuar me meshkujt, 27.8 për qind.

Ndërsa sa i përket grup moshave, papunësia më e theksuar është te grup moshat 15-24 vjeçare me 53.3%.

Sipas ekspertëve të kësaj fushe shifrat në teren tregojnë se papunësia është shumë më e madhe se sa raportohet, për vet faktin se Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk bën matje të shpeshta të kësaj dukurie.

Sa u përket të punësuarve me kontrata, del se 28.1% e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 71.9% kanë kontratë të përkohshme.

Ky disproporcion mes të punësuarve të gjinisë femrore dhe mashkullore na dëshmon se është një indikatorë që reflekton në përkeqësimin e raporteve bashkëshortore dhe për pasojë ka në raste të caktuara edhe shfaqjen e dhunës në familje.⁷⁰

6. Stresi dhe pasojat e saja në familje

Çdokush mund të jetë viktimë, ato mund të jenë të çdo moshe, gjinie, race, kulture, besimi, niveli arsimor, statusi social dhe ekonomik. Megjithëse si gratë edhe burrat mund të abuzohen, por në shumicën e rasteve gratë janë viktima të dhunës. Fëmijët të cilët jetojnë në familje ku ka dhunë, kanë gjasa të jenë të abuzuar, ose së paku të neglizhuar. Të gjithë këta fëmijë e njohin dhunën, madje edhe në rastet kur nuk dhunohen fizikisht, ata mund të kenë probleme emocionale dhe të sjelljes.

Dhuna është krim, kur ajo përfshin dëmtimin fizik (djegien, përplasjen, prerjen etj), abuzim seksual (aktivitet seksual pa dëshirë dhe me forcë) dhe përndjekjen (me qëllim dëmtimi). Nga ana tjetër, megjithëse abuzimi emocional, psikologjik dhe financiar nuk janë sjellje kriminale ato janë forma të abuzimit dhe mund të çojnë në dhunë kriminale.⁷¹

⁷⁰ Papunësia në Kosovë, më e lartë se sa e tregojnë statistikat", portali "Indeksonline", shikuar për herë të fundit me 14 Janar 2018, ora 22:51

⁷¹ Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

Stresi që shkaktohet p.sh te fëmijët të cilët jetojnë në një familje ku ushrohet dhuna familjare në përgjithësi, manifestohet me sjellje kriminale në shoqëi që vije si rezultat i traumave dhe stresit të shkaktuar në familje, pra në vendin ku ai do të duhej të ndjehej i sigurtë dhe të ketë qetësinë e duhur.

Pasojat e saja mund të jenë aq të transmetueshme, sa që fëmijët e rritur në një familje ku ushrohet dhunë, mësohen dhe imitojnë gjithmon prindërit e tyre, andaj ata në të ardhmen do të jenë edhe vet abuzues ndaj fëmijëve ose anëtarëve të tjerë në familje. Pra dhuna si dukuri, stresi që shkaktohet nga ushtrimi i cilësdo dhunë ka pasoja rrënjësore në zhvillimin e shoqërisë së shëndoshë dhe pa dhunë.

KAPITULLI III

EFEKTET DHE PASOJAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMEVE MARTESORE

1. Prishja e raporteve familjare

Dukuria e përkeqësimit dhe e prishjes së raporteve familjare është një ndër shkaktarët kryesor të shfaqjes së dhunës në familje, brenda anëtarëve të familjes, duke reflektuar negativisht në të gjithë pjesëtarët e familjes dhe duke e zbehur në thelb rolin për të cilën ajo si e tillë është krijuar dhe ekziston në shoqëri. Ndër format e dhunës që ndikojnë dhe kanë refleksione direkte në prishjen e raporteve brenda familjes janë disa forma të dhunës që atakojnë rëndë antarët e familjes, sidomos gratë, fëmijët, të moshuarit, etj. Sipas burimeve statistikore dhuna në familje në Kosovë na dëshmon se edhe, burrat vuajnë të gjitha format e dhunës në familje, duke përfshirë edhe dhunën psikologjike, ekonomike dhe fizike, po me një intensitet shumë më të vogël se sa femrat. Gjithsej, 40.9% e të gjitha grave të anketuara thanë se kanë vuajtur nga dhuna në familje në vitin 2014, krahasuar me vetëm 9.7% të burrave të anketuar. Në mënyrë të qartë, gratë janë më shumë të rrezikuara nga dhuna në familje sesa burrat. Tradicionalisht grave gjithashtu u janë mohuar të drejtat e garantuara me ligje për të trashëguar apo regjistruar pronë në emrin e tyre. Kjo situatë në të cilën gjenden gratë sa i përket të drejtave të tyre pronësore, bënë gjithashtu një ndarje jo të barabartë të marrëdhënieve të pushtetit familjar dhe i bënë ato shumë më të prekshme nga dhuna në familje. Në mes të këtyre faktorëve social dhe ekonomik, gratë dhe vajzat mbeten të papërfaqësuar jo vetëm në marrëdhëniet familjare por edhe më gjerë duke evidentuar kështu praninë e një sërë paragjykimesh stereotipike që ushqejnë modelet tradicionale familjare.⁷² Prishja e raporteve bashkëshortore poashtu ka refleksione direkte në përkeqësimin e raporteve ndaj anëtarëve të tjerë të familjes, sidomos fëmijëve të mitur (djem dhe vajza) tek të cilët një situatë e tillë ka ndikime direkte në anën emocionale të fëmijëve të cilët janë shpeshherë edhe subjekt ataktimi nga prindërit si pasojë e përkeqësimit të raporteve bashkëshortore, duke qenë të njejtit dëshmitarë të dhunës në familje, siç cilësohet edhe me Konventën e Stambollit. Poashtu, edhe të moshuarit janë një kategori e rrezikuar dhe e atakuar nga dhuna në familje, por ata për shkak

⁷² Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, vepër e cituar.

të moshës, ballafaqimi me probleme të ndryshme gjatë jetës hezitojnë të flasin për dhunë, dhe si e tillë ajo mbetet një “temë tabu”, etj.⁷³.

2. Zgjidhja e martesës dhe pasojat e saja

Zgjidhja e martesës shoqërohet nga disa pasoja juridike, të cilat janë të rregulluara me ligj, të cilat shfaqen në një plan të dyfishtë. Një pjesë e tyre kanë të bëjnë me mbarimin e marrëdhënies martesore, ndërkohë që një pjesë tjetër i referohet ruajtjes apo lindjes së disa të drejtave të reja pas zgjidhjes së martesës. Në të njëjtën kohë, zgjidhja e martesës shuan për të ardhmen marrëdhënie martesore ndërmjet bashkëshortëve dhe për rrjedhojë të drejtat dhe detyrimet që buronin nga kjo martesë. Kështu, si pasojë e zgjidhjes së martesës, ish bashkëshortët nuk do të kenë më detyrimin për jetesë të përbashkët, për besnikëri bashkëshortore, për mbështetje emocionale, për bashkëpunimin në interes të familjes, e të tjera si këto. Shuarja e këtyre ndodh pra, automatikisht me vërtetimin e faktit të zgjidhjes së martesës. Me rastin e zgjidhjes së martesës i jepen fund marrëdhënieve juridike ndërmjet bashkëshortëve të krijuara si rezultat i lidhjes së martesës. Në këtë kuptim, zgjidhja e martesës përfaqëson një fakt juridik me vërtetimin e të cilit ligji parashikon shuarjen e marrëdhënies martesore. Sikurse dhe fakti juridik i vdekjes së njërit bashkëshort, edhe zgjidhja e martesës sjell pasoja për të ardhmen. Disa autorë përmendin si pasoja juridike të shkurorëzimit: pasojat emocionale, ligjore, ekonomike, sociale dhe psikike dhe pasojat rreth bashkëpunimit me rastin e shkurorëzimit, etj. Pasojat konsistojnë në pushimin, ndryshimin apo krijimin e disa të drejtave e detyrimeve ndërmjet ish bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre. Efektet juridike të shkurorëzimit të natyrës emocionale reflektohen në emocionet e bashkëshortëve, duke qenë se prishja e martesës nënkupton edhe prishjen e lidhjes emocionale me ish bashkëshortin. Efektet ligjore shfaqen në aspektin e zhvillimit të procedurave ligjore me rastin e shkurorëzimit, duke qenë se shkurorëzimi bëhet vetëm me procedurë gjyqësore. Shkurorëzimi përfshin edhe efekte ekonomike që reflektohen në pasurinë e bashkëshortëve dhe ndarjen e kësaj pasurie me rastin

⁷³ Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, vepër e cituar.

e shkurorëzimit. Ndërsa në bazë të kriterit të objektit të pasojave që rrjedhin pas zgjidhjes së martesës, si në rastin e marrëdhënieve ndërmjet ish bashkëshortëve, etj. Pra, shkaktohen pasojat e zgjidhjes së martesës në marrëdhëniet personale pasurore; Pasojat në marrëdhëniet pasurore lidhen me: detyrimin e mbështetjes materiale, trashëgiminë, pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, banesën familjare, detyrimin ushqimor të bashkëshortit të pasiguruar; dhurimin; Problemet e banimit; Detyrimi për ushqim; Shtetësia e fituar si pasojë e martesës; Problemet që shkaktohen nga zgjidhja e martesë janë edhe problemet që janë krijuar gjatv martesës si kreditor ose debitor ndaj subjekteve të treta; Mospasja e mjete të mjaftueshme për të jetuar; Problemet kur njëri ish bashkëshort është i paaftë për punë; Pabarazia ndërmjet kushteve të mëparshme të jetesës dhe atyre pas zgjidhjes së martesës; Pamundësia objektive e sigurimit të mjeteve për një jetesë dinjitoze nga bashkëshorti që pretendon kontributin kompensues; Problemet e dhuratave mes ish bashkëshortëve; Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët, etj.⁷⁴

3. Traumata psikike tek fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes

Dhuna në familje, e më saktë dhuna psikike është njëra ndër format të cilat më së shumti e determinojnë sjelljen e fëmijëve në të ardhmen dhe krijimin e tyre si persona të rritur. Prindërit të cilët rrisin fëmijët e tyre me një dhunë psikike dhe sistematike, duke e ndryshuar varësisht nga mosha që kanë këta fëmijë, fëmijëve u krijojnë ndjenjën e frikës dhe pasigurisë, ndjenjen e mosbesimit që fillon nga prindërit dhe pastaj në shoqëri. Këta fëmijë gjithmonë do të ndjehen të pasigurt dhe ndjenjën e sigurisë të cilët prindërit kanë për obligim t'i ofrojnë fëmijëve të tyre shndërrohet në frikë dhe mosbesim ndaj tyre. Ku fëmija humb besimin ndaj prindërve atëherë edhe në jetën jashtë familjes të ilën dosmsdo do të krijojë, nuk do të mund të krijoj asnjëherë besim në asnkënd dhe në asgjë. Ndjenja e frikës për cdo vendim dhe veprim

⁷⁴ Shiko më gjerësisht: Ahmedi , S. (2016), Zgjidhja e Martesës (shkurorëzimi). vështrim krahasues: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Punim doktorial, Universitetit European të Tiranës.

që fëmija ka shkakton në humbjen e vetbesimit dhe kjo kushton shumë në krijimin e një jete të mirë në kohën kur shoqëria ka dinamizmin dhe zhvillohet me hapa shumë më të shpejtë sesa shoqëria mund ta përcjellë.

4. Dobësimi i familjes si celula më e rëndësishme e shoqërisë

Dobësimi i familjes si celula më e rëndësishme e shoqërisë ndodh pikërisht kur lidhjet e shëndosha mes anëtarëve të familjes, zbehen nga kushtet dhe rrethanat e krijuara nga vetë ata. Kur një familje e cila duhet të jetë vendi më i qetë, më mbrojtës, besues, i ngrohtë dhe me dashuri, shndërrohet në një familje e cila rolin e fëmijëve e sheh si skllav që i kanë bërë për ti shfrytëzuar, si fëmijë të cilët qëllimi i jetës së tyre është të i binden urdhërave dhe dëshirave të prindërve të tyre ata fëmijë asnjëherë nuk do të mund të krijojnë marrëdhënie të ngrohta me prindërit e tyre. Këtu fillon edhe dobësimi i familjes, në ngurtësimin e marrëdhënieve fëmije-prind. Kjo vazhdon me dhunën e vazhdueshme cilado formë qoftë ajo, e cila detyron anëtarët e familjes të marrin vendime që bazohen në dëshirën e lirisë dhe ndjenjës për të jetuar një jetë ndryshe dhe më të mirë. Sjellja e prindërve mes vete dhe sjellja e tyre ndaj fëmijëve rezultojnë me krijimin ose jo të ndjenjës për të qëndruar bashkë dhe për të forcuar celulën më të rëndësishme të shoqërisë, familjen. Pra, forcimin e saj duke forcuar raportet e caktuara me secilin anëtarë të familjes.

5. Viktimat nga dhuna në familje dhe krimet martesore

Dhuna ndaj gruas është një epidemi globale që ndikon në radhë të parë në shëndetin dhe stabilitetin social dhe ekonomik të gruas, familjes së saj, komunitetit ku ajo jeton. Kur gratë janë viktimat e dhunës në familje, shumë shpesh ndodh që e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë tek institucionet shëndetësore, të mbrojtjes, apo të drejtësisë. Kjo bën që dhuna e përsëritur dhe në vazhdimësi, ta bëjë gruan dhe vajzën jo vetëm një viktimë të përkohshme por të paafte të vazhdojë jetën e saj normale për t'u angazhuar në jetën sociale ekonomike të

familjes së saj por edhe me gjerë. Por, ndërsa dhuna është një fenomen i shtrirë në të gjithë Globin, në vendet në zhvillim dhe me specifika të zhvillimit ekonomik, social historik, të traditës (siç janë vendet e Ballkanit), dhuna ndaj gruas paraqet sfida të veçanta. Studimet tregojnë në kontinuitet se dhuna e ushtruar ndaj gruas nga partnerët e ngushtë shkakton probleme serioze në vdekshmërinë amnore dhe mbijetesën e fëmijëve.

- Në 48 studime të kryera në vende të ndryshme të Botës, 10-69 % të grave të pyetura kanë pohuar se kanë pësuar dhunë fizike dhe psikologjike, nga partnerët e tyre të ngushtë, në situata të ndryshme të jetës së tyre.
- Partnerët shkaktojnë 40-70 % të vdekjeve të grave në kushtet e shtëpisë.
- Një në tre gra, rrihet, abuzohet seksualisht ose lëndohet fizikisht, nga njeri prej anëtareve të familjes, ku gjasat më të mëdha i ka partneri, bashkëshorti, babai.
- Studimet e bëra në disa vende tregojnë se 50% e grave që janë dhunuar fizikisht gjatë jetës së tyre, kanë pësuar dhunë edhe gjatë shtatzënisë.
- Studimet tregojnë për një korrelacion të ngushtë të dhunës fizike dhe seksuale me rastet e HIV AIDS. Kjo ndodh pasi partnerët e dhunshëm, u kërkojnë grave të tyre të mos marrin masa mbrojtëse ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetuara.
- Historitë e dhunës dhe abuzimit në jetën e një gruaje shkaktojnë pasoja negative afatgjata për shëndetin e saj mendor.
- Për fat të keq ndodhshmëria e abuzimit fizik të grave gjatë periudhës së shtatzënisë, në vendet e zhvilluara është rritur , nga 4 % në 20%. Këtu ndikon edhe shkalla e ndërgjegjësimit për denoncimin e dhunës.
- Gratë e dhunuara rrezikojnë dy herë më shumë të humbin fëmijën e tyre të pa-lindur, dhe katër herë më shumë të kenë një fëmijë të lindur nën peshën normale.

- Studimet në disa vende tregojnë se fëmijët e lindur nga një grua e dhunuar rrezikojnë gjashtë herë më shumë të vdesin para moshës 5 vjeç.⁷⁵

Viktimat e dhunës në familje në Kosovë kanë në dispozicion disa mekanizma mbrojtës. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje përcakton tre lloje urdhrash mbrojtës, dhe atë duke përfshirë:

- urdhrat e mbrojtjes,
- urdhrat e mbrojtjes emergjente të lëshuara nga gjykatat dhe
- urdhrat e mbrojtjes së përkohshme të emergjente të lëshuar nga Policia e Kosovës jashtë orarit të rregullt të punës.

Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (PSV) specifikojnë rolet dhe përgjegjësitë ligjore të secilit institucion për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje siç janë Policia e Kosovës, Prokuroria, Avokatët e Viktimave, Qendrat për Punë Sociale dhe Strehimoret. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se këto institucione shpesh dështojnë në zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe të PSV-ve. Në të kaluarën, dështimet për të lëshuar urdhra për mbrojtje nga gjykatat kanë çuar në vdekje tragjike. Veçanërisht, rasti i Diana Kastratit⁷⁶ përmendet shpesh si një dështim i hapur i gjykatës për të lëshuar urdhrat e mbrojtjes në kohën e duhur. Kastrati u qëllua për vdekje nga ish bashkëshorti i saj në qendër të qytetit të Prishtinës në maj të vitit 2011. Tre javë përpara incidentit tragjik, znj. Kastrati kërkoi dhe nuk arriti të marrë urdhër mbrojtës nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Dështimi i gjykatës për të zbatuar Nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe për të lëshuar urdhrin për mbrojtje emergjente brenda 24 orëve, siç kërkohet me ligj, çoi në vdekjen e saj tragjike. Diana u qëllua në publik nga ish burri i saj, pa një urdhër mbrojtjeje të lëshuar nga gjykata në kohën kur ajo u qëllua për vdekje. Në përgjigje ndaj këtij keqpërdorimi, u dorëzua pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës një çështje gjyqësore kundër Gjykatës Komunale të Prishtinës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përfundimisht

⁷⁵ Hulumtime të bëra për nevojat e Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

⁷⁶ <https://kallxo.com/lajm/gjykata-e-detyron-shtetin-e-kosoves-ti-paguaje-95-mije-euro-familjes-se-diana-kastratit/>

Gjykata Kushtetuese e shpalli shtetin përgjegjës dhe shkelës të së drejtës së viktimës për jetën për shkak të pamundësisë së gjykatës për të lëshuar urdhrin e mbrojtjes në kohën e duhur.⁷⁷

RAST STUDIMI: VALBONA MARKU- NDRECAJ DHE VAJZA E SAJ⁷⁸

Valbona Marku-Nrecaj dhe vajza e saj u vranë nga bashkëshorti, respektivisht i ati në gusht të vitit 2018. Valbona kishte raportuar dhunën dhe kërcënimet e bashkëshortit të saj shumë here përpara incidentit, bile edhe disa orë para vdekjes së saj. Më 12 maj 2018 Valbona e kishte raportuar dhunën e bashkëshortit të saj dhe ai ishte mbajtur në paraburgim për vetëm një muaj – pas së cilës kohë ai ishte liruar – gjoja për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.⁷³ Prokuroria ishte në dijeni se i dyshuari kishte në posedim një armë zjarri. Kur Valbona kishte raportuar disa kërcënime që ajo kishte marrë nga bashkëshorti i saj me telefon, përfshirë edhe një kërcënim 5 orë para se të ndodhte vrasja, policia kishte vlerësuar se kërcënimet nuk paraqisnin asnjë rrezik për viktimën. Duke mos iu përgjigjur raportimeve të akteve të kërcënimeve të dhunës në familje dhe duke mos përdorur mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën me qëllim të parandalimit të dhunës së mëtejshme, policia ka shkelur nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Më tej, policia ka dështuar të kryej një vlerësim të vlefshëm dhe aktual të rrezikshmërisë me qëllim të ofrimit të shërbimit dhe mbrojtjes së përshtatshme ndaj Valbonës. Edhe pse vlerësimi fillestar i rrezikut është kryer kur është intervistuar viktimja dhe kur është plotësuar Forma e të Dhënave Bazike, PSV-të aktuale poashtu nuk kërkojnë që të bëhet ndonjë vlerësim i vlefshëm, i vazhdueshëm dhe i detajuar i rrezikut për rastet e raportuara më herët. Një listë kontrolli i policisë për vlerësimin e rrezikut përbëhet nga 5-6 kontrolle që nuk i plotësojnë kushtet e vlerësimit të vlefshmërisë së rrezikut. Sikur policia ta përditësonte vlerësimin e rrezikut nga Forma e të Dhënave Bazike dhe menjëherë të përgjigjej ndaj kërcënimeve të jetës së saj duke urdhëruar lëshimin e një Urdhëri të Përkohshëm të Mbrojtjes Emergjente, vdekja e Valbonës dhe vajzës së saj do të ishin shmangur. Më tej, Policia nuk ka lëshuar menjëherë një Urdhër të Përkohshëm të Mbrojtjes Emergjente për Valbonën në pajtim me nenin 22 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Policia deklaroi se përgjegjësia e tyre

⁷⁷ Qosaj-Mustafa, A. & Morina, D., veper e cituar, fq.16.

⁷⁸ <https://kallxo.com/ligji/gjykata/pjeter-ndrecaj-i-denuari-me-burgim-te-perjetshem-serish-para-gjykates/>

kishte përfunduar për shkak të faktit se Valbona nuk kishte kërkuar ndonjë urdhër mbrojtje. Për më tepër policia ishte informuar se autori i krimit posedonte armë zjarri, porse as polici dhe as prokurori nuk kishin kërkuar konfiskimin e armës së zjarrit nga autori i krimit. Një urdhër i tillë mund të kërkohej nga palë të shumta, përfshirë viktimat, çdo person i autorizuar nga viktimat, avokati i viktimës, dikush që ka një marrëdhënie familjare me viktimën, përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale, ose çdo person me njohuri të drejtpërdrejtë të aktit apo akteve të dhunës në familje të ushtruara kundër viktimës. Institucione të tjera ishin përfshirë në rastin e Valbonës, përfshirë edhe Qendrën për Punë Sociale dhe Avokati i Viktimave. Të gjitha këto institucione ishin të vetëdijshme për dhunën sistemike të gjatë që po ushtrohej kundër Valbonës. Sipas nenit 22 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Qendrat për Punë Sociale mund të kërkojnë lëshimin e një urdhëri në emër të viktimës, drejtpërdrejt kur fëmijët vihen në rrezik. Qendrat për Punë Sociale mund të kërkojnë lëshimin e Urdhrave për Mbrojtjen dhe Urdhrave për Mbrojtje të Jashtëzakonshme në rastet kur dhuna gjithashtu prek direkt fëmijët. Reagimi i dobët, mungesa e koordinimit si dhe zbatimi i dobët i roleve dhe përgjegjësi të parapara në Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë nga Policia e Kosovës, Qendra për Punë Sociale dhe palët e tjera të përfshira, përfshirë edhe shërbimet e prokurorisë kanë kontribuar në masë të madhe në rëndimin e kushteve për vdekjen e Valbonës dhe vajzës së saj nëntëvjeçare.⁷⁹

⁷⁹Qosaj-Mustafa, A. & Morina, D., vepër e cituar, fq.20

KAPITULLI IV

MASAT PREVENTIVE DHE REPRESIVE PËR LUFTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE DHE KRIMEVE MARTESORE

1. Masat preventive

Viktimat e dhunës në familje në Kosovë kanë në dispozicion disa mekanizma mbrojtës. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje përcakton tre lloje urdhrash mbrojtës, dhe atë duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes, urdhrat e mbrojtjes emergjente të lëshuara nga gjykatat dhe urdhrat e mbrojtjes së përkohshme të emergjente të lëshuar nga Policia e Kosovës jashtë orarit të rregullt të punës. Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (në tekstin e mëtejshëm: PSV) specifikojnë rolet dhe përgjegjësitë ligjore të secilit institucion për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje siç janë organizatave joqeveritare, i masmediave, avokatët e viktimave, Qendrat për Punë Sociale, etj. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se këto institucione shpesh dështojnë në zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe të PSV-ve. Në të kaluarën, dështimet për të lëshuar urdhra për mbrojtje nga gjykatat kanë çuar në vdekje tragjike sic ka qene rasti i Diana Kastratit⁸⁰ përmendet shpesh si një dështim i hapur i gjykatës për të lëshuar urdhrat e mbrojtjes në kohën e duhur. Kastrati u qëllua për vdekje nga ish bashkëshorti i saj në qendër të qytetit të Prishtinës në maj të vitit 2011. Tre javë përpara incidentit tragjik, znj. Kastrati kërkoi dhe nuk arriti të marrë urdhër mbrojtës nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Dështimi i gjykatës për të zbatuar Nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe për të lëshuar urdhrin për mbrojtje emergjente brenda 24 orëve, siç kërkohet me ligj, çoi në vdekjen e saj tragjike. Diana u qëllua në publik nga ish burri i saj, pa një urdhër mbrojtjeje të lëshuar nga gjykata në kohën kur ajo u qëllua për vdekje. Në përgjigje ndaj këtij keqpërdorimi, u dorëzua pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës një çështje gjyqësore kundër Gjykatës Komunale të Prishtinës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përfundimisht Gjykata Kushtetuese e shpalli shtetin përgjegjës dhe shkelës të së drejtës së

⁸⁰ Court awards family of Diana Kastrati €95,000 in compensation, 11/09/2019 - 10:49
<https://prishtinainsight.com/court-awards-family-of-diana-kastrati-95000-euros-in-compensation/>

viktimës për jetën për shkak të pamundësisë së gjykatës për të lëshuar urdhrin e mbrojtjes në kohën e duhur.⁸¹

1.1. Roli i organizatave joqeveritare

Roli i shoqërisë civile në mbrojtjen e viktimave dhe monitorimin e dhunës në familje është me rëndësi të veçantë për parandalimin e kësaj dukurie të dhunës dhe krimit. Në vitin 2004, disa organizata joqeveritare (në tekstin e mëtejme: OJQ) kanë hartuar Programin Nacional të Dhunës ndaj Grave për Evropën Qendrore dhe atë Lindore, Evropën Juglindore dhe Kaukazin, Azinë Qendrore dhe Mongolinë. Keto OJQ lidhur e çështjen e parandalimit të dhunës në familje me theks të veçantë ndaj grave dhe të barazisë gjinore kanë qenë monitorues Nacional të Dhunës Ndaj Grave, ë cilat në aktivitetin e tyre kanë ndërmarrë vepime të shumta monitoruese lidhur me dukurinë e dhunës në familje. OJQ-ja e zgjedhur si Monitorues Nacional i Dhunës Ndaj Grave për Kosovën, ishte Qendra Kosovare për Studime Gjinore e cila ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të këtij organizimi, përfshirë menaxhimin e ëebfaqes vendore për Kosovën. Gjithashtu, në Kosovë është një numër i organizatave jo qeveritare që trajtojnë edhe fenomenin e dhunës në familje.⁸²

1.2 Roli i masmediave

Media ka rol të rëndësishëm në krijimin dhe promovimin e një opinioni të fuqishëm shoqëror kundër dhunës në familje. Ato duhet të jenë më të ndjeshme ndaj fenomenit të dhunës në familje, më këmbëngulëse në promovimin e vlerave të familjes dhe të kenë qëndrim të prerë kundër stereotipeve me bazë gjinore. Informimi mbi dhunën në familje nga ana e medias ka rëndësi të veçantë për qasjen në mënyrë kritike ndaj fenomenit, por edhe për

⁸¹U neglizhua nga gjykata – shteti i Kosovës detyrohet t’ia paguajë 95 mijë euro familjes së Diana Kastratit, <https://insajderi.com/u-ngelizhua-nga-gjykata-shteti-i-kosoves-detyrohet-tia-paguaje-95-mije-euro-familjes-se-diana-kastratit/>, Tetor 2019.

⁸² Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

përcjelljen e mesazheve në dobi të vetëdijesimit të popullatës e sidomos të brezit të ri. Megjithatë jo gjithmonë raportimi i dhunës bëhet konform etikës profesionale, në jo pak raste, dhuna në familje është përdorur si skupë gazetaresk e jo si mënyrë kritike për t'ju qasur fenomenit dhe për të sensibilizuar opinionin publik.⁸³

1.3. Roli i Qendrës për Punë Sociale

Qendrat për Punë Sociale, megjithëse e kanë në mandatin e tyre ndihmën dhe përkrahjen e viktimave janë pasive në rastin e dhunës në familje.

Qendrat për Punë Sociale janë të obliguara që të bashkëpunojnë me të gjithë akteret në procesin e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Nëse QPS vlerëson se viktimat ka nevojë për strehim e siguron strehimin për viktimën në OJQ-te përkatëse nga të cilat MPMS blen shërbime për Viktimat e dhunës në familje. Nëse Gjykata shqipton urdhër për mbrojtje ajo e njofton QPS-ne dhe kjo e fundit nëse vrenë se urdhri po shkilet ka obligim ta njoftoj gjykatën me qëllim të mbrojtjes së viktimës. QPS gjegjësisht Organi i Kujdestarisë ka obligim që të marrë pjesë në cilën do procedurë që ftohet kur është në pyetje mbrojtja e interesit me të mirë të miturit. Sa i përket mbajtjes së kontakteve të prindërve me fëmijët, QPS-te janë të obliguar të respektojnë vendimet e gjykatave dhe të ndërmjetësojnë në mbajtjen e kontakteve nëse gjykata e ka lënë mbajtjen e kontakteve nëpërmes QPS-ve. Të gjithë akteret tjerë kanë obligim të njoftojnë QPS-te për rastin e dhunës me qëllim që rasti të menaxhohet dhe viktimës ti ofrohen shërbime sociale sipas nevojave që ajo/ai ka . Të gjithë Nëpunësit e Shërbimeve Sociale gjatë punës së tyre duhet të respektojnë “Kodin e Etik” dhe ofrimin e shërbimeve të bëjnë në mënyrë profesionale bazuar në Ligje dhe Standarde që janë të përcaktuara për ofrimin e shërbimeve sociale .⁸⁴

Qendra për Punë Sociale është institucion publik i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare ,në këtë kontekst edhe mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në ri-integrim të viktimës .Gjithashtu

⁸³ Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

⁸⁴ Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

koordinon aktivitetet me akterët tjerë në procesin e mbështetjes së viktimës dhe fuqizimit të saj/tij. Qendra për punë sociale (QPS) ndihmon viktimat e dhunës në familje kur nevojiten shërbimet sociale, mbrojtje, rehabilitim dhe integrim të viktimave në shoqëri. Çdo viktme të referuar i caktohet një menaxher i rastit, i cili është zyrtar që emërohet nga QPS për të ndihmuar në identifikimin dhe koordinimin e shërbimeve ekzistuese.⁸⁵

1.4. Roli i Mbrojtësit të Viktimave

Mbrojtësi i viktimave - personi i autorizuar zyrtar i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, monitoron mbarëvajtjen e procesit gjyqësor në rastet kur viktimat pranojnë ndihmën nga Mbrojtësi i Viktimave, kur Mbrojtësi i Viktimës është i involuar në rast.⁸⁶

⁸⁵ Agjencia për Barazi Gjinore, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë bazuar në Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014

⁸⁶ Agjencia për Barazi Gjinore, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë bazuar në Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014

2 .Masat penale, administrative dhe civile

Kodi Penal i mëparshëm i Kosovës (KPK) nuk ofronte një përkufizim të dhunës në familje, pavarësisht kësaj, dhuna në familje përmendej për herë të parë në këtë Kod vetë në aspektin formal.

Sipas legjislacionit penal dështimi për të raportuar abuzimin e fëmijëve ose të dhunës në familje është veprë penale dhe kushdo që nuk i raporton veprat penale që ndodhin brenda një marrëdhënieje në familje mund të ndiqet penalisht. Legjislacioni penal i mëparshëm parashihte ndjekjen penale “ex-officio” të krimeve të lëndimeve të lehta trupore, lëndim i rëndë trupor, kushte të ngjashme me skllavërinë, puna e detyruar, përdhunimi dhe sulmi seksual kur kryhet në marrëdhënie familjare.

Sipas legjislacionit penal të tanishëm shkelja e urdhërave të mbrojtjes konsiderohet bazë për ndjekje penale sipas detyrës zyrtare, të mbështetura në Ligjin e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje⁸⁷. Në ndryshimet që u bënë në Kodin Penal të Kosovës në vitin 2012, janë ofruar edhe përkufizimet në përcaktimin e viktimës së ndjeshme dhe të Fondit për Kompensimin e Viktimës.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës⁸⁸ e sanksionon edhe veprën penale të dhunës në familje si he parasheh sanksionet penale për veprën e tillë. Kështu, sipas nenit 248. Sipas këtij neni kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet. Poashtu, kur çfarëdo veprë në Kodin Penal kryhet brenda marrëdhënies familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese për kryesin e veprës. Gjithashtu, kjo dispozitë ligjore parasheh që çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Kodi Penal përcakton një numër të veprave të tjera penale të kryera në marrëdhëniet familjare që mund të konsiderohen si një bazë për ndjekje penale. Megjithatë, në Kodin Penal nuk përfshihen të gjitha aktet e dhunës në

⁸⁷ Ligji nr. 03/I-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje e Kosovës, neni 26, paragrafi 1

⁸⁸ Kodi nr. 06/I-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 248

familje të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës detyron subjektet publike të raportojnë krimet që duhet të ndiqen sipas detyrës zyrtare. Në nenin 63 paragrafin 2 të tij, theksohet rritja e rolit të Mbrojtësit të Viktimës për të përfaqësuar të gjitha viktimat e krimit.⁸⁹

- a) **Prokuroria** - Prokurori i shtetit ka detyrimin për të shqyrtuar provat e një incidenti të dhunës në familje për të përcaktuar nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme për të justifikuar dhe mbështetur ndjekjen penale të rastit. Kjo përfshin edhe çdo shkelje të urdhërave të mbrojtjes. Bashkëpunimi midis prokurorëve dhe policisë është vendimtar në rastet e dhunës në familje. Krahas një linje të rregullt telefonike të Policisë së Kosovës, është krijuar edhe një numër publik falas 0800 11 112 për thirrjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje që funksionon 24 orë. Ky numër menaxhohet nga mbrojtësit e viktimave të Divizionit për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave që funksionon në kuadër të Prokurorisë së Shtetit. Kur vihen në dijeni për një rast, prokurorët janë të detyruar të marrin veprime të menjëhershme lidhur me të dhe t'i japin përparësi duke marrë parasysh specifikat e rastit. Prokurorët janë të detyruar edhe të sigurojnë që gjatë intervistave të jenë të pranishëm të gjithë personat që parashikohen me ligj duke përfshirë personin që ka pësuar dhunën, Mbrojtësin e Viktimës, punonjësin social, prokurorin, dhe mjekët. Në detyrat e tjera të prokurorëve bën pjesë mbikëqyrja e punës së policisë kryesisht e NjHDhF-ve,⁹⁰ për të siguruar që të ndërmerren të gjitha hapat për mbledhjen e provave. Pasi përfundojnë hetimet dhe kur provat janë të mjaftueshme, prokuroria pa vonesë, duhet të ngrejë padi ose t'i hedhë poshtë akuzat. Të gjitha informatat që lidhen me rastin duhet të mbahen konfidenciale deri në momentin e ngritjes së akuzave, moment ky në të cilin informatat bëhen publike. I dyshuari mund të arrestohet dhe t'i shqiptohet masa e paraburgimit. Masat e paraburgimit mund të shqiptohen nga një gjyqtar i procedurës paraprake pas propozimit me shkrim të prokurorisë pas plotësimit të kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Në rastin e fëmijëve viktimë, prokurori ka për detyrë të zhvillojë ndjekjen penale në mënyrën që i shërben interesave më të mira të

⁸⁹ Kodi nr. 04/l-123 i Procedurës Penale të Kosovës, neni 63.

⁹⁰ Njësia për Hetime rreth Dhunës në Familje, në kuadër të Policisë së Kosovës

fëmijës. Prokuroria ka prokurorë të caktuar veçanërisht, të cilët koordinojnë punën në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

b) Gjykatat - luajnë një rol vendimtar në procesin e sigurimit të një trajtimi të drejtë dhe të ligjshëm të rasteve të dhunës në familje. Ato janë përgjegjëse për trajtimin në mënyrë të paanshme dhe me dinjitet të të gjitha palëve duke përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe kryesit e veprës penale. Si pjesë të procedurës civile, gjykatat shqyrtojnë kërkesat për urdhër të mbrojtjes dhe urdhërat për mbrojtje emergjente duke vendosur për masat e mbrojtjes të cilat parashikohen nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Gjykatat janë të detyruara që të marrin vendime lidhur me urdhërat për mbrojtje brenda afateve ligjore të parapara në Ligj si dhe duhet t'i shqyrtojnë rastet e dhunës në familje si çështje me përparësi. Në procedurat penale gjykatat kanë kompetencë të dënojnë kryesit e veprave penale që hyjnë në sferën e dhunës në familje si dhe personat të cilët kanë shkelur urdhërat për mbrojtje. Gjykatat kanë për obligim që t'i njoftojnë të gjitha palët në procedurë për të drejtat që u përkasin atyre si dhe pasojat e mosveprimit të tyre. Pavarësisht këtij funksioni që kryejnë aktualisht, me qëllim përmirësimin e situatës dhe trajtimin me prioritet të rasteve të dhunës në familje, grupi punues për hartimin e kësaj strategjie sugjeroi që: gjykatat, në procedurë penale, duhet të ndryshojnë politikën ndëshkimore në raport me kryesit penalë të veprave të dhunës në familje si dhe personave të cilët shkelin urdhërat mbrojtës. Gjykatat duhet t'u përmbahen në mënyrë strikte obligimeve ligjore rreth njoftimit të palëve në procedurë për të drejtat e tyre dhe pasojat eventuale të mos shfrytëzimit të këtyre të drejtave.

Mund të konkludojmë se të dhënat institucionale ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për të monitoruar praninë e dhunës në familje dhe të krimeve martesore në Kosovë, pasi që nuk ekziston një mekanizëm i veçantë institucional për të përcjellur rastet e hetuara, ndjekura penalisht dhe të gjykuar nga institucionet gjyqësore. Poashtu, nuk ka të dhëna të ndara mbi krimet e dhunës në baza gjinore, që mund të përdoren për të identifikuar se sa vrasje në Kosovë janë kryer si rezultat i përkeqësimit të marrëdhënieve familjare.

Ligji mbi mbrojtjen nga dhuna në familje⁹¹ nuk është efikas sa duhet. Për të duhen rregulla të qarta zbatuese. Njohja e dobët e legjislacionit nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve paraqet një pengesë shtesë. Niveli i njohjes së Konventave ndërkombëtare dhe zbatimit nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët është i kufizuar. Problemet me kuadrin ligjor qëndrojnë në faktin se, ndërsa konventat e ratifikuara nga Parlamenti i Kosovës, lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi, dhe të grave e fëmijëve në veçanti, janë të shumta, e në bazë të Kushtetutës quhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të detyrueshme për zbatim, niveli i njohjes së tyre dhe zbatimit nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët është i kufizuar. Këto instrumente janë të panjohura prej viktimave të dhunës në familje. Kjo sjell mos aplikimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemi i drejtësisë, dhe mosvënien e tyre në shërbim të viktimave dhe të atyre që kërkojnë qasje në drejtësi (nga monitorimi i vendimeve gjyqësore ka rezultuar se përgjithësisht referimi tek këto konventa është pothuajse jo-ekzistues).

Janë evidente shtyrjet në lëshimin e urdhrave mbrojtës dhe dënime të buta për kryerësit recidivist dhe shkelësit e urdhrave mbrojtës.

Gjyqtarët civil kanë një rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së viktimave të dhunës në familje përmes lëshimit të urdhrit të mbrojtjes. Megjithatë janë identifikuar një numër çështjesh kritike që kanë të bëjnë me përgjigjet nga gjyqtarët dhe vendimet e tyre mbi urdhrat mbrojtës. Kështu hulumtimi i bërë për këtë qëllim ka treguar se

- a) ka shtyrje në lëshimin e urdhrave mbrojtës;
- b) dënime të lehta për përsëritësit dhe shkelësit e urdhrave mbrojtës;
- c) lëshim i kufizuar i masave të parapara sipas ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje arsyetim i dobët i aktvendimeve me të cilat shqiptohen urdhrat mbrojtës;
- d) dhe vëmendje e kufizuar në sigurimin e zbatimit të urdhrit mbrojtës.

Vihen re dënime të buta të dhëna nga Gjykatat lidhur me recidivistët dhe shkelësit e urdhrave të mbrojtjes.

Lëshim i kufizuar i masave të parapara sipas rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje Megjithëse Rregullorja parasheh një numër të masave të cilat krijojnë bazë për mirëqenien afatgjate të viktimës, siç janë: urdhri për të paguar qiranë e banesës së viktimës ose fëmijëve të

⁹¹ Ligji mbi mbrojtjen nga dhuna në familje , 03/I-182

saj kur siguria dhe mirëqenia e viktimës nuk lejon kthimin në banesën e përbashkët; pagesën e alimentacionit për kohëzgjatjen e Urdhërit të Mbrojtjes; kthimin e fëmijëve të viktimës duke caktuar kujdes të përkohshëm; ndalimin e shitjes së pasurisë nga viktimat ose kryerësi derisa Urdhërit të Mbrojtjes është valide, etj.

Sipas Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore⁹² dhuna me bazë gjinore konsiderohet si formë diskriminimi konform nenit 4.2 i ligjit. Megjithatë, Kosova ende nuk ka ndonjë përkufizim të dhunës me bazë gjinore në procedurat penale dhe civile. Përkundër kornizës ligjore, e cila mbulon disa akte të dhunës me bazë gjinore, mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës dhe holistik të dhunës me bazë gjinore në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, ndikon ndjekjen efektive dhe dënimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Dhe, edhe pse përkufizimet për dhunim, vrasje, veprime kundër partnerëve të brendshëm dhe disa krime të tjera të dhunës në baza gjinore ekzistojnë në legjislacion, hetimi dhe ndjekja e krimeve të tilla vazhdojnë të karakterizohen me shkallë të ulët të dënimit.

Sigurimi i qasjes efektive dhe me kohë në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore është një hap i rëndësishëm drejt integritit të Kosovës në BE. Praktika ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që ka të bëjë me dhunën me bazë gjinore, megjithëse e detyrueshme për Kosovën, përdoret rrallë nga gjyqësori i Kosovës. Kështu, një sfidë e vazhdueshme mbetet përdorimi i të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga gjyqësori i Kosovës.

⁹² Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore., nr.05/L-020

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Dukuria e dhunës në familje dhe krimeve martesore mbetet një ndër sfidat kryesore të institucioneve shtetërore në Republikën e Kosovës. Kjo dukuri është një rrezik permanent për shoqërinë kosovare dhe më gjerë. Ajo si e tillë ka refleksione negative edhe për ekonominë, raportet shoqërore në vend ku janë evidente këto dukuri. Në të gjitha shtetet moderne mirëqenia e qytetarit dhe e familjes duhet të jetë prioriteti kryesor i politikës shtetërore dhe e strategjisë zhvillimore.

Dhuna në familje dhe krimet martesore cenojnë rëndë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ajo manifestohet në forma të ndryshme në një shoqëri, prandaj, dukuria e tillë shkakton pasoja të mëdha sociale, politike, ekonomike, juridike në një shoqëri dhe si e tillë dëmton rëndë kredibilitetin e familjes, shoqërisë dhe shtetit si subjekt i veçantë, si brenda ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Sfidë e veçantë paraqet edhe identifikimi i shkaqeve të dhunës në familje dhe krimeve martesore me qëllim të parandalimit dhe luftimit sa më efikas të saj. Rol të rëndësishëm në luftimin e kësaj dukurie luajnë institucionet shtetërore, policia, prokuroria, gjykatat, por edhe organizatat joqeveritare, masmediat etj.

Infrastruktura ligjore e Republikës së Kosovës deri diku është e mjaftueshme dhe e kënaqshme në sferën e parandalimit dhe luftimit të dhunës në familje dhe krimeve martesore, problemi qëndron vetëm në zbatueshmërinë praktike të tyre dhe në rritjen dhe ashpërsimin e sanksioneve për veprat e tilla abuzive dhe kriminale. Si rekomandime lidhur me temën e punimit popozojë:

- Të amandamentohet Ligji mbi Familjen me theks në procedurat për adresimin e dhunës në familje;
- Të fuqizohen mekanizmat ligjor zbatues të parapara për adresimin e dhunës në familje;
- Të fuqizohen mekanizmat ligjor në kuadër të shkollës dhe institucioneve të tjera për adresimin e dhunës;

- Të ngrihen shërbime profesionale në shkolla dhe institucione tjera lidhur e këtë çështje;
- Të ngrihen institucione të shërbimeve (ligjore, sociale, arsimore e shëndetësore) për viktimat dhe ushtruesit e dhunës të financuara nga buxheti i shtetit;
- Të krijohen qendra sociale dhe rehabilituese për viktimat dhe ushtruesit e dhunës;
- Krijimi i hapësirave (në institucionet) për median për pasqyrimin real dhe të drejtë të rasteve të dhunës;
- Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe jo-publike për shërbimet ndaj viktimave të dhunës;
- Të krijohen linja buxhetore për mbulimin e nevojave të strehimoreve dhe të viktimave të dhunës në familje;
- Të përmirësohen kushtet e punës për punonjësit social të qendrave sociale që duhet të ndjekin rastet e emergjencës;
- Të sigurohet mbështetje financiare për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje (nënave vetushqyese) gjatë periudhës së ndarjes nga familja dhe kjo të parashihet në ligj;
- Të ngrihen banesa sociale për strehim të përkohshëm të viktimave të dhunës në familje;
- Të ngrihen kapacitetet e punonjësve të shëndetësisë për trajtimin shëndetësor dhe social të viktimave të dhunës;
- Të ngrihen kapacitetet e psikologëve të shkollave për identifikimin dhe trajtimin e problemeve të dhunës në familje;
- Të ngrihen kapacitetet e punonjësve social në Qendrat për Punë Sociale dhe në strehimore;
- Të ngrihen kapacitete e punonjësve të medias veçanërisht e gazetarëve për trajtimin e dhunës në familje;
- Të ngrihen kapacitetet e gjyqtarëve në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje;

- Të krijohet një program këshillimi për familjen pranë qendrave për punë sociale;
- Të unifikohet dhe plotësohet data baza me të dhënat për dhunën në familje pranë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale;
- Të bëhen më efektive linjat pranë policisë për raportimin e dhunës;
- Të krijohen programe të kreditimit të viktimave për të rifilluar një aktivitet ekonomik – biznesor;
- Të nxiten programe të vecanta për fuqizimin e familjes;
- Të ngrihen programe të punësimit, formimit profesional, ndërmjetësimit për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje;
- Të ngrihen programe të vetëdijesimit në shkollë, komunitet për parandalimin e dhunës në familje;
- Të ngrihen urat e bashkëpunimit të institucioneve me median dhe shoqërinë civile për parandalimin e dhunës në familje;
- Të ngrihen programe të rehabilitimit për viktimat dhe ushtruesit e dhunës;
- Të ngrihen programe të trajtimit afatgjatë për viktimat e dhunës deri në ri-integrimin e tyre të plotë në jetën normale (strehim, punësim mbrojtje ligjore mbështetje psiko-sociale), etj.

LITERATURA E SHFRYTEZUAR DHE KONSULTUAR:

1. Libra, artikuj shkencorë

- Mandro.A & Anastasi.a& Shkurti. E & Bozo.A, “Barazia Gjinore dhe mosdiskriminimi”, Tiranë 2011
- Merlika,R. (2018), Kanuni i Bendës - Pjesë e së drejtës zakonore shqiptare, temë (e pabotuar) e doktoratës në Universitetin Europian të Tiranës
- Mustafa-Qosaj, A., & Morina,D., (2018) Raport i Politikave - Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë, Kosovar Institute for Policy Research and Development
- Fuga Artan, & Dervishi Zyhdi, “Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global”, Botime Dudaj, Shtypshkronja “Gutenberg”, Tiranë 2010
- Bejko Juljan, “Norbert Elias”, Sociologji e qytetërimeve, Edlora 2014
- Hasanbelliu, A., Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Dhunës në Familje, Tiranë, 2017
- Fatos Tarifa & Judith Blau, Randall Collins, Amitai Etzioni, Arne Kalleberg, Sherryl KLEINMAN, Pepper Schëartz, Susan Silbey, George Steinmetz, Bryan Turner, Richard Udry, Immanuel Eällerstein, Jay Eëinstein et al.; “Shkencat e shoqërisë, Sociologjia si disiplinë integruese për studimin e jetës shoqërore”,
- Krista McQUEENEY& Matheë B.EZZELL & Kenneth H. KOLB& Sherryl KLEINMAN, “Sociologjia dhe studimet gjinore. Riprodhim i pabarazisë nëpërmjet “dallimit”, Onufri, Tiranë 2013
- Krol, K., (2017), Krijimi i Hartës së Shërbimeve Mbështetëse për Viktimat e Dhunës ndaj Grave në Kosovë, Projekti i Këshillit të Evropës, “Forcimi i Luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë”
- Fatos Tarifa, “Imagjinata sociologjike dhe bota jonë sociale”, Onufri, Tiranë 2014
- Leke Sokoli, “Sociologjia”, Elio, Tiranë 1997
- Ragip Halili, Sanksionet penale sipas të drejtës zakonore në Kosovë, Prishtinë, 1985
- Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016
- Vesel Latifi & Agron Beka, Vrasjet, Krimi i organizuar, Terrorizmi, Prishtinë, 2013
- Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2014

- Vesel Latifi & Haki Demolli, Kriminalistika, Prishtinë, 2019
- Vasilika Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2014
- Tamo, A. dhe Karaj, Th., Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri, Tiranë, 2005
- Milan Milutinovic, Kriminologjia, Prishtinë, 1982
- Dervishi. Z, “Sociologjia”, SHBLSH E RE, Tiranë 2013
- Sokoli, Lekë.,” Refleksione Sociologjike”, Tiranë 2008 QNL,
- Anastasi, Aurela & Saraci, Besa & Bozo, Aurela, Raport, “Zbatimi i ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, Tiranë 2010 QNL,
- Anastasi, Aurela & Saraci, Besa & Bozo, Aurela, Raport, “Zbatimi i ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”,Tiranë 2010
- Material i prezantuar për OJF-të nga A.Gjurgji (DPPSH), “Dhuna në familje. Masat e marra dhe rezultatet e arritura kundër këtij fenomeni. 2008-2010” Dhuna me bazë gjinore si shprehje e pabarazive strukturore dhe tendencave sociale 225
- Mariana Semini-Tutulani, “Konfliktet gjyqësore të punës nën këndvështrimin gjinor”, Botimet Morava, Tiranë 2015
- Këshilli i Evropës, “Përmbledhje e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi çështjet e barazisë gjinore”.
- Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, SOROS, “Përmirësimi i mekanizmave mbrojtës të të drejtave të njeriut në luftën kundër diskriminimit”
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, shtëpia botuese “Kuvendi”, Shkodër, 1999
- Kanuni i Skënderbeut, mbledhur e kodifikuar nga dom. Frano Ilia, 1993
- Afërdita Deva-Zuka e bashkautorët: Partneriteti Shkollë-Familje-Komunitet, Prishinë 2012;
- Ylli, Valentina: Manual për fillimin e edukimit të të drejtave të njeriut, Tiranë, 2001;
- Nuhiu, Armend: Udhëzues për fëmijë dhe prindër-ndëshkimi fizik i fëmijëve, Shkup 2016;
- Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit, 2011-2014;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), miratuar dhe shpallur nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 217A(III) e 10 dhjetorit 1948.
- Material studimor “Raport kombëtar i Projektit “Mbështetja për të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor” – 2006 – zbatuar nga 14 OJF shqiptare.
- Nisma për të Drejtat e Grave, USAID, Shqipëri, Krijimi i një skuadre për bashkërendimin e reagimit ndaj dhunës në familje në Shqipëri”, 2006.
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020
- “Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës”, Jon Smibert, Ambasada Amerikanë në Prishtinë, 2013

2. Tekste ligjore: Kushtetuta, Kode, ligje, Konventa:

- Ligji i Kosovës kundër Dhunës në Familje, Nr.03/L-182, i vitit 2010
- Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore., nr.05/L- 020
- Kodi nr. 04/l-123 i Procedures Penale i Kosovës
- Kushtetuta e Maqedonisë Nr. 08-4642/1, 17 nëntor 1991, me ndryshmet tjera kushtetuese deri më 2019
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 139/2008, me ndryshimet dhe plotësime
- Ligji për parandalim, ndalesë dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr..138/2014, 33/2015, 150/2015
- Konventa ndërkombëtare “Për të drejtat civile dhe politike, (ICCPR). Konventa ndërkombëtare “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (ICESCR).
- Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” (CEDAË). Deklarata e Kombeve të Bashkuara e vitit 1963, “Për eliminimin e dhunës kundër grave”
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1948.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të amenduara nga Protokollet 11 dhe 14, Këshilli i Europës, 1950
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, 1989
- Konventa Europiane (BE) “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore”, e miratuar në vitin 1950, hyrë në fuqi më 1953).
- Karta Sociale Europiane – e vitit 1965. Konventa europiane “Për parandalimin e torturës, të trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese”, e vitit 1998.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2010
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Pjesa e Përgjithshme, 2013.
- Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2012.
- Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2008.
- Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Ismet Elezi, Skënder Kaçupi, Maksim Haxhia, 2012.

- Kodi Civil dhe i Procedurës Civile i Shqipërisë, të pasuruar me praktikë Gjyqësore dhe e përditësuar me ndryshimet e 2012. Nga shtëpia botuese AlbJuris, 2012.
- Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit, 2011-2014;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), miratuar dhe shpallur nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 217A(III) e 10 dhjetorit 1948.
- Material studimor “Raport kombëtar i Projektit “Mbështetja për të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor” – 2006 – zbatuar nga 14 OJF shqiptare.
- Nisma për të Drejtat e Grave, USAID, Shqipëri, Krijimi i një skuadre për bashkërendimin e reagimit ndaj dhunës në familje në Shqipëri”, 2006.
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020
- “Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës”, Jon Smibert, Ambasada Amerikanë në Prishtinë, 2013

3. Të dhëna statistikore:

- Këshlli Gyqësor i Kosovës për periudhën 2015 -2018
- Këshlli Prokuroria i Kosovës për periudhën 2015 -2018
- Të dhënat statistikore nga Gjykatat në Kosovë për periudhën 2015 -2018
- Të dhëna statistikore nga Njësia për Hetime rreth Dhunës në Familje, në kuadër të Policisë së Kosovës periudhën 2015 -2018.

4. Burime nga internet:

- <https://ëëë.kosovopolice.com/> dt.01.04.2020, ora 00:15.
- <https://insajderi.com/u-ngelizhua-nga-gjykata-shteti-i-kosoves-detyrohet-tia-paguaje-95-mije-euro-familjes-se-diana-kastratit/>, qasja e fundit 5 Tetor 2019.
- <https://kallxo.com/ligji/gjykata/pjeter-ndrecaj-i-denuari-me-burgim-te-perjetshem-serish-para-gjykates/>, qasja e fundit me 10.05.2020